



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 88

27 maj

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 146/2013 datë 6.5.2013	Për ratifikimin e Konventës për Ndihmën Administrative të Ndërsjellë në Çështjet Tatimore..... 3719
Ligj nr. 147/2013 datë 6.5.2013	Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Artigiancassa S.p.A. për financimin e programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare..... 3731
Ligj nr. 148/2013 datë 6.5.2013	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar 3743
Ligj nr. 149/2013 datë 6.5.2013	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 2.5.2013, të Këshillit të Ministrave “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”..... 3749
Ligj nr. 150/2013 datë 6.5.2013	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 3.5.2013, të Këshillit të Ministrave “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim Abu Dhabi për financimin e projektit të bulevardit verior dhe të rehabilitimit të Lumit të Tiranës”..... 3750

LIGJ
Nr. 146/2013

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS PËR NDIHMËN ADMINISTRATIVE
TË NDËRSJELLË NË ÇËSHTJET TATIMORE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa për Ndhmën Administrative të Ndërsjellë në Çështjet Tatimore.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 6.5.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8183, datë 21.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

KONVENTË
PËR NDIHMËN ADMINISTRATIVE TË NDËRSJELLË
NË ÇËSHTJET TATIMORE

Tekst i ndryshuar me dispozitat e Protokollit që ndryshon Konventën për Ndhmën Administrative të Ndërsjellë në Çështjet Tatimore, i cili ka hyrë në fuqi më 1 qershor 2011.

Preambulë

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe vendet anëtare të Organizatës për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin (OECD), nënshkruese në këtë konventë,

duke marrë parasysh që zhvillimi i lëvizjes ndërkombëtare të personave, kapitalit, mallrave dhe shërbimeve, megjithëse në vetvete është tepër i dobishëm, ka rritur mundësitë e shmangies dhe evazionit fiskal dhe kështu kërkon bashkëpunim në rritje ndërmjet autoriteteve tatimore;

duke mirëpritur përpjekjet e ndryshme të bëra në vitet e fundit për luftën kundër shmangies tatimore dhe evazionit fiskal në nivel ndërkombëtar, qoftë në kuadër dypalësh ose shumëpalësh;

duke marrë parasysh që një përpjekje e bashkërenduar ndërmjet shteteve është e nevojshme, me qëllim që të nxiten të gjitha format e ndihmës administrative në çështjet në lidhje me tatimet e çdolloji, duke siguruar në të njëjtën kohë mbrojtje të përshtatshme të të drejtave të tatim-paguesve;

duke njohur që bashkëpunimi ndërkombëtar mund të luajë rol të rëndësishëm në lehtësimin e caktimit të përshtatshëm të detyrimeve tatimore dhe në ndihmën e tatim-paguesve në sigurimin e të drejtave të tyre;

duke marrë parasysh që parimet themelore që i japin të drejtë çdo personi që të drejtat dhe detyrimet e tij të përcaktohen në pajtim me një procedurë të përshtatshme ligjore duhet të njihen si të zbatueshme për çështjet tatimore në të gjitha shtetet dhe që shtetet duhet të përpiqen të mbrojnë interesat



e ligjshme të tatim-paguesve, duke përfshirë mbrojtjen e përshtatshme kundër diskriminimit dhe tatimit të dyfishtë;

duke qenë kështu të bindur se shtetet duhet të zbatojnë masat ose të japin informacion duke pasur parasysh domosdoshmërinë e mbrojtjes së konfidencialitetit të informacionit dhe duke marrë parasysh instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e jetës private dhe rrjedhën e të dhënave personale;

duke pasur parasysh që ka lindur një mjedis i ri bashkëpunimi dhe që është e dëshirueshme që të bëhet i disponueshëm një instrument shumëpalësh për t'i mundësuar një numri sa më të madh shtetesh të marrin përfitimet e mjedisit të ri bashkëpunues dhe në të njëjtën kohë të zbatojnë standardet më të larta ndërkombëtare të bashkëpunimit në fushën tatimore;

me dëshirën për të lidhur një konventë për ndihmën administrative të ndërsjellë në çështjet tatimore,

kanë rënë dakord si më poshtë:

KAPITULLI I OBJEKTI I KONVENTËS

Neni 1

Objekti i konventës dhe personat e mbuluar

1. Palët, në pajtim me dispozitat e kapitullit IV, i japin njëra-tjetrës ndihmë administrative të ndërsjellë në çështjet tatimore. Kjo ndihmë mund të përfshijë, sipas rastit, masat e marra nga organet gjyqësore.

2. Kjo ndihmë administrative përbëhet nga:

a) shkëmbimi i informacionit, duke përfshirë ekzaminime të njëkohshme tatimore, dhe pjesëmarrja në ekzaminimet tatimore jashtë shtetit;

b) ndihmën në kompensimin, duke përfshirë masat e ruajtjes; dhe

c) dorëzimin e dokumenteve.

3. Një palë jep ndihmë administrative nëse personi i prekur është rezident apo shtetas i një Pale apo i çdo shteti tjetër.

Neni 2

Tatimet e mbuluara

1. Kjo konventë zbatohet:

a) për tatimet e mëposhtme:

i) tatimin mbi të ardhurat ose fitimin;

ii) tatimet mbi fitimet kapitale;

iii) tatimet mbi pasurinë neto,

të vendosura për llogari të një Pale; dhe

b) për tatimet e mëposhtme:

i) tatimet mbi të ardhurat, fitimet, fitimet kapitale ose pasurinë neto që vendosen në emër të nënndarjeve politike ose autoriteteve lokale të një Pale;

ii) kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të pagueshme qeverisë qendrore ose institucioneve të sigurimeve shoqërore të ngritura në bazë të së drejtës publike; dhe

iii) tatimet në kategori të tjera, përveç detyrimeve doganore, të vendosura për llogari të një Pale, që janë:

A. tatimet mbi pasurinë, trashëgiminë ose dhurimet;

B. tatimet mbi pasurinë e paluajtshme;

C. tatimet e konsumit të gjerë, si tatimi mbi vlerën e shtuar ose shitjet;

D. tatimet specifike mbi mallrat dhe shërbimet, si tatimet e akcizës;

E. tatimet mbi përdorimin ose pronësinë e mjeteve motorike;

F. tatimet mbi përdorimin ose pronësinë e pasurisë së luajtshme të ndryshme nga mjetet motorike;

G. çdo tatim tjetër;

iv) tatimet në kategoritë e përmendura nga nënparagrafi “iii” më sipër, të cilat vendosen për llogari të nënndarjeve politike ose autoriteteve lokale të një Pale.

2. Tatimet ekzistuese për të cilat zbatohet konventa janë renditur në aneksin A në kategoritë e përmendura në paragrafin 1.

3. Palët njoftojnë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës ose Sekretarin e Përgjithshëm të OECD-së (më poshtë quhen “depozitarët”) për çdo ndryshim që duhet të bëhet në aneksin A si rezultat i një modifikimi në listën e përmendur në paragrafin 2. Një ndryshim i tillë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Depozitari.

4. Konventa zbatohet gjithashtu që nga miratimi i saj, për çdo tatim të barsvlershëm ose thelbësisht të ngjashëm, i cili vendoset në një shtet kontraktues pas hyrjes në fuqi të konventës në lidhje me atë Palë përveç ose në vend të tatimeve ekzistuese të renditura në aneksin A dhe, në këtë rast, Pala përkatëse njofton një prej depozitarëve për miratimin e tatimit në fjalë.

KAPITULLI II PËRKUFIZIME TË PËRGJITHSHME

Neni 3

Përkufizime

1. Për qëllimet e kësaj konvente, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe:

a) termat “shteti kërkues” dhe “shteti i kërkuar” do të thonë përkatësisht çdo Palë që bën kërkesë për ndihmë administrative në çështjet tatimore dhe çdo Palë të kërkuar të japë një ndihmë të tillë;

b) termi “tatim” do të thotë çdo tatim ose kontribut të sigurimeve shoqërore për të cilin konventa zbatohet në pajtim me nenin 2;

c) termi “dëm tatimor” do të thotë çdo shumë tatimore, si dhe interesi mbi të, në lidhje me gjobat administrative dhe koston me qëllim kompensimin, të cilat janë borxh, por nuk janë paguar ende;

d) termi “autoritet kompetent” do të thotë personat dhe autoritetet e renditura në aneksin B;

e) termi “shtetas” në lidhje me një Palë do të thotë:

i) të gjithë individët që kanë shtetësinë e asaj Pale; dhe

ii) të gjithë personat juridikë, partneritetet, shoqatat dhe subjektet e tjera që përftojnë statusin e tyre si të tilla nga ligjet në fuqi në atë Palë.

Për çdo Palë që ka bërë një deklaratë për këtë qëllim, termat e përdorur më sipër kuptohen sipas përkufizimit në aneksin C.

2. Në lidhje me zbatimin e konventës nga një Palë, çdo term që nuk është i përkufizuar në të, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, ka kuptimin që ai ka në bazë të ligjit të asaj Pale në lidhje me tatimet e mbuluara nga konventa.

3. Palët njoftojnë një prej depozitarëve për çdo ndryshim që do të bëhet në anekset B dhe C. Një ndryshim i tillë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga depozitari në fjalë.

KAPITULLI III FORMAT E NDIHMËS

Seksioni I

Shkëmbimi i informacionit

Neni 4

Dispozita të përgjithshme

1. Palët shkëmbejnë çdo informacion, veçanërisht sipas parashikimit në këtë seksion, që çmohet i rëndësishëm për administrimin ose zbatimin e ligjeve të tyre të brendshme në lidhje me tatimet e mbuluara nga kjo konventë.



2. Shfuqizuar.

3. Çdo Palë, me deklaratë drejtuar njërit prej depozitarëve, përcakton që, sipas legjislacionit të saj të brendshëm, autoritetet e saj mund të informojnë rezidentin ose shtetasin e saj para transmetimit të informacionit në lidhje me të, në pajtim me nenet 5 dhe 7.

Neni 5

Shkëmbimi i informacionit sipas kërkesës

1. Me kërkesë të shtetit kërkues, shteti i kërkuar i jep shtetit kërkues çdo informacion të përmendur në nenin 4 që ka lidhje me persona ose veprime juridike të caktuara.

2. Nëse informacioni i disponueshëm në dosjet tatimore të shtetit të kërkuar nuk është i mjaftueshëm për t'i mundësuar atij të përmbushë kërkesën për informacion, ai shtet merr të gjitha masat përkatëse për t'i dhënë shtetit kërkues informacionin e kërkuar.

Neni 6

Shkëmbimi automatik i informacionit

Në lidhje me kategoritë e çështjeve dhe në pajtim me procedurat që vendosin me marrëveshje të ndërsjellë, dy ose më shumë Palë shkëmbejnë automatikisht informacionin e përmendur në nenin 4.

Neni 7

Shkëmbimi spontan i informacionit

1. Një Palë, pa kërkesë paraprake, i paraqet një Palë tjetër informacionin për të cilin ka marrë dijeni në rrethanat e mëposhtme:

- a) Pala e parë ka shkak për të supozuar që mund të ketë humbje tatimore në Palën tjetër;
- b) një person që i nënshtrohet tatimit, përfton një ulje ose përjashtim nga tatimet në Palën e përmendur më parë, gjë që shkakton rritjen tatimore ose detyrimin e tij tatimor në Palën tjetër;
- c) marrëdhëniet e biznesit ndërmjet një personi që i nënshtrohet tatimit në një Palë dhe një personi që i nënshtrohet tatimit në Palën tjetër zhvillohen përmes një ose më shumë vendeve në mënyrë të tillë që një kursim tatimor mund të rezultojë në njërën ose Palën tjetër apo në të dyja;
- d) një Palë ka shkak të supozojë që një kursim tatimor mund të rezultojë nga transfertat artificiale të fitimeve brenda grupeve të ndërmarrjes;
- e) informacioni i dhënë Palës së parë nga Pala tjetër ka mundësuar marrjen e informacionit që mund të jetë i rëndësishëm në vlerësimin e detyrimit tatimor në palën e fundit.

2. Secila Palë merr masa dhe zbaton procedurat që janë të nevojshme për të siguruar që informacioni i përshkruar në paragrafin 1, të ofrohet për t'u transmetuar në Palën tjetër.

Neni 8

Ekzaminimet tatimore të njëkohshme

1. Me kërkesë të njërit prej tyre, dy ose më shumë Palë konsultohen bashkërisht, me qëllim caktimin e çështjeve dhe procedurave për ekzaminime tatimore të njëkohshme. Secila Palë e përfshirë vendos nëse dëshiron të marrë pjesë në një ekzaminim tatimor të njëkohshëm.

2. Për qëllimet e kësaj konvente, një ekzaminim tatimor i njëkohshëm do të thotë një masë ndërmjet dy ose më shumë Palëve për të shqyrtuar njëkohësisht, secila në territorin e vet, çështjet tatimore të një ose disa personave ku ata kanë interes të përbashkët ose të lidhur, me qëllim shkëmbimin e çdo informacioni përkatës që marrin në këtë mënyrë.

Neni 9

Ekzaminimet tatimore jashtë shtetit

1. Me kërkesë të autoritetit kompetent të shtetit kërkues, autoriteti kompetent i shtetit të kërkuar mund të lejojë përfaqësuesit e autoritetit kompetent të shtetit kërkues të jenë të pranishëm në pjesën e përshtatshme të një ekzaminimi tatimor në shtetin e kërkuar.

2. Nëse kërkesa miratohet, autoriteti kompetent i shtetit të kërkuar, sa më shpejt të jetë e mundur, njofton autoritetin kompetent të shtetit kërkues në lidhje me kohën dhe vendin e ekzaminimit, autoritetin ose zyrtarin e caktuar për të kryer ekzaminimin dhe procedurat dhe kushtet e kërkuara nga shteti i kërkuar për kryerjen e ekzaminimit. Të gjitha vendimet në lidhje me zhvillimin e ekzaminimit tatimor merren nga shteti i kërkuar.

3. Një Palë mund të informojë një prej depozitarëve në lidhje me synimin e saj për të mos pranuar, si rregull i përgjithshëm, ato kërkesa që janë përmendur në paragrafin 1. Një deklaram i tillë mund të bëhet ose tërhiqet në çdo kohë.

Neni 10

Informacioni konfliktues

Nëse një Palë merr nga Pala tjetër informacion në lidhje me çështjet tatimore të një personi i cili duket se nuk është në përputhje me informacionin në zotërim të tij, ajo vë në dijeni për këtë Palën që ka dhënë informacionin.

Seksioni II

Ndihma për kompensim

Neni 11

Kompensimi i dëmeve tatimore

1. Me kërkesë të shtetit kërkues, shteti i kërkuar, në pajtim me dispozitat e neneve 14 dhe 15, ndërmerr hapat e nevojshëm për të kompensuar dëmet tatimore të shtetit të parë kontraktues, sikur të ishin dëmet e veta tatimore.

2. Dispozita e paragrafit 1 zbatohet vetëm për dëmet tatimore që janë objekt i një instrumenti që lejon ekzekutimin e tyre në shtetin kërkues dhe, nëse nuk bihet dakord ndryshe ndërmjet Palëve të interesuara, të cilat nuk kundërshtohen.

Megjithatë, nëse dëmi është kundër një personi, i cili nuk është rezident i shtetit kërkues, paragrafi, nëse nuk bihet dakord ndryshe ndërmjet Palëve të interesuara, zbatohet vetëm nëse dëmi nuk mund të kundërshtohet më.

3. Detyrimi për të dhënë ndihmë për kompensimin e dëmeve tatimore në lidhje me një person të vdekur ose pasurinë e tij kufizohet në vlerën e pasurisë ose pronës së përfutur nga çdo përfitues i pasurisë, në varësi të faktit nëse dëmi do të kompensohet nga pasuria apo nga përfituesit e saj.

Neni 12

Masat e ruajtjes

Me kërkesë të shtetit kërkues, shteti i kërkuar, me qëllim kompensimin e një shume tatimore, merr masa për ruajtjen edhe nëse dëmi kundërshtohet apo nuk është objekt i një instrumenti që lejon ekzekutimin.



Neni 13

Dokumentet shoqëruese të kërkesës

1. Kërkesa për ndihmë administrative sipas këtij seksioni shoqërohet nga:

a) një deklaratë që dëmi tatimor lidhet me një tatim që mbulohet nga konventa dhe, në rastin e kompensimit, që në pajtim me paragrafin 2 të nenit 11, dëmi tatimor nuk është ose nuk mund të kundërshtohet;

b) një kopje zyrtare të instrumentit që lejon ekzekutimin në shtetin kërkues; dhe

c) çdo dokument tjetër që kërkohet për kompensimin ose masat e ruajtjes.

2. Instrumenti që lejon ekzekutimin në shtetin kërkues, nëse është e përshtatshme dhe në pajtim me dispozitat në fuqi në shtetin e kërkuar, pranohet, njihet, plotësohet ose zëvendësohet, sapo të jetë e mundur pas datës së marrjes së kërkesës për ndihmë, nga një instrument që lejon ekzekutimin në shtetin e fundit.

Neni 14

Afatet kohore

1. Çështjet në lidhje me çdo periudhë tej së cilës një dëm tatimor nuk mund të ekzekutohet, rregullohen nga ligji i shtetit kërkues. Kërkesa për ndihmë jep hollësisht në lidhje me këtë periudhë.

2. Veprimet kompensuese të kryera nga shteti i kërkuar në pajtim me një kërkesë për ndihmë, e cila, sipas ligjeve të atij shteti, do të kishte efektin e pezullimit ose të ndërprerjes së periudhës së përmendur në paragrafin 1, ka gjithashtu këtë efekt sipas ligjeve të shtetit kërkues. Shteti i kërkuar njofton shtetin kërkues për këto veprime.

3. Në çdo rast, shteti i kërkuar nuk është i detyruar të respektojë një kërkesë për ndihmë, e cila paraqitet pas një afati prej 15 vjetësh nga data e instrumentit fillestar që lejon ekzekutimin.

Neni 15

Prioriteti

Dëmet tatimore në kompensimin e të cilave jepet ndihmë, nuk kanë në shtetin e kërkuar ndonjë prioritet që u jepet specifikisht dëmeve tatimore të atij shteti edhe nëse procedura e përdorur e kompensimit është një prej atyre që përdoret për dëmet e veta tatimore.

Neni 16

Shtyrja e pagesës

Shteti i kërkuar mund të lejojë shtyrjen e pagesës ose pagesën me këste nëse ligjet ose praktika e tij administrative e lejon këtë në rrethana të ngjashme, por njofton së pari shtetin kërkues.

Seksioni III

Dorëzimi i dokumenteve

Neni 17

Dorëzimi i dokumenteve

1. Me kërkesë të shtetit kërkues, shteti i kërkuar i dorëzon marrësit dokumente, duke përfshirë ato në lidhje me vendimet gjyqësore, të cilat rrjedhin nga shteti kërkues dhe që lidhen me tatimet e mbuluara nga kjo konventë.

2. Shteti i kërkuar realizon dorëzimin e dokumenteve:

a) me një metodë të parashikuar nga ligji i tij i brendshëm për dorëzimin e dokumenteve të një natyre thelbësisht të ngjashme;

b) në masën që është e mundur, me një metodë të veçantë të kërkuar nga shteti kërkues ose më të afërt me këtë metodë që parashikohet sipas ligjeve të veta.

3. Një palë mund të realizojë dorëzimin e dokumenteve drejtpërdrejt me postë te një person brenda territorit të një Pale tjetër.

4. Asgjë në këtë konventë nuk interpretohet sikur zhvlerëson dorëzimin e dokumenteve nga një Palë në pajtim me ligjet e veta.

5. Nëse një dokument dorëzohet në pajtim me këtë nen, nuk është i nevojshëm të shoqërohet me përkthim. Megjithatë, nëse dihet që marrësi nuk mund të kuptojë gjuhën e dokumentit, shteti i kërkuar merr masa për përkthimin ose për një përmbledhje të hartuar në gjuhën ose një prej gjuhëve të tij zyrtare. Ndryshe, ai mund t'i kërkojë shtetit kërkues të përkthejë dokumentin ose ta shoqërojë me një përmbledhje në një prej gjuhëve zyrtare të shtetit të kërkuar, Këshillit të Europës ose OECD-së.

KAPITULLI IV DISPOZITAT NË LIDHJE ME FORMAT E NDIHMËS

Neni 18

Informacioni që duhet të jepet nga shteti kërkues

1. Një kërkesë për ndihmë përcakton sipas rastit:

a) autoritetin ose agjencinë që ka iniciuar kërkesën e bërë nga autoriteti kompetent;

b) emrin, adresën, dhe çdo hollësi tjetër që ndihmon në identifikimin e personit në lidhje me të cilin bëhet kërkesa;

c) në rastin e një kërkesë për informacion, forma në të cilën shteti kërkues dëshiron që të jepet informacioni për të përmbyshur nevojat e tij;

d) në rastin e një kërkesë për kompensim ose masat e ruajtjes, natyra e dëmit tatimor, përbërësit e dëmit tatimor dhe sendet pasurore nga të cilat mund të kompensohet dëmi tatimor;

e) në rastin e një kërkesë për dorëzimin e dokumenteve, natyrën dhe subjektin e dokumenteve që duhet të dorëzohen;

f) nëse është në pajtim me ligjin dhe praktikën administrative të shtetit kërkues dhe nëse është e justifikuar sipas kërkesave të neni 21.2g.

2. Sapo në vëmendje të tij të vijë një informacion tjetër në lidhje me kërkesën për ndihmë, Shteti kërkues ia kalon atë shtetit të kërkuar.

Neni 19

Shfuqizuar

Neni 20

Përgjigja ndaj kërkesës për ndihmë

1. Nëse kërkesa për ndihmë përmbyshet, shteti i kërkuar njofton shtetin kërkues në lidhje me veprimet e ndërmarra dhe rezultatet e ndihmës sa më shpejt të jetë e mundur.

2. Nëse kërkesa refuzohet, shteti i kërkuar njofton sa më shpejt të jetë e mundur shtetin kërkues në lidhje me këtë vendim dhe shkakun e tij.

3. Nëse, në lidhje me një kërkesë për informacion, shteti kërkues ka specifikuar formën në të cilën dëshiron të paraqitet informacioni dhe shteti i kërkuar është në gjendje ta bëjë këtë, shteti i kërkuar i jep informacionin në formën e kërkuar.

Neni 21

Mbrojtja e personave dhe kufijtë e detyrimit për dhënien e ndihmës

1. Asgjë në këtë konventë nuk cenon të drejtat dhe garancitë e siguruara personave nga ligjet dhe praktika administrative e shtetit të kërkuar.



2. Përveçse në rastin e nenit 14, dispozitat e kësaj konvente nuk interpretohen sikur për Shtetin e kërkuar vendosin një detyrim:

a) për të zbatuar masat në kundërshtim me ligjet ose praktikën administrative apo ligjet e veta ose praktikën administrative të shtetit kërkuar;

b) për të zbatuar masat që do të ishin në kundërshtim me politikën publike (rendin publik);

c) të japë informacionin, i cili nuk mund të merret në bazë të ligjeve apo praktikave administrative të tij ose të ligjeve të shtetit kërkuar apo praktikës së tij administrative;

d) të japë informacion që do të deklaronte ndonjë sekret tregtar, biznesi, industrial, tregtar ose profesional apo proces tregtar, ose informacionin deklarimi i të cilit do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendin publik);

e) të japë asistencë administrative nëse dhe në masën që ai është i mendimit që tatimi në shtetin kërkuar do të ishte në kundërshtim me parimet përgjithësisht të pranuar për tatimet ose me dispozitat e një konvente për shmangien e tatimit të dyfishtë ose të një konvente tjetër që shteti i kërkuar ka lidhur me shtetin kërkuar;

f) të japë asistencë administrative për qëllimet e administrimit ose zbatimit të një dispozite të ligjit tatimor të shtetit kërkuar, ose një kërkesë në lidhje me të, e cila diskriminon një shtetas të shtetit të kërkuar në krahasim me një shtetas të shtetit kërkuar në të njëjtat rrethana;

g) të japë ndihmë administrative nëse shteti kërkuar nuk ka ndjekur të gjitha masat e arsyeshme të disponueshme, në pajtim me ligjet ose praktikën e vet administrative, përveç kur zbatimi i këtyre masave do të shkaktonte një vështirësi disproporcionale;

h) të japë ndihmë në kompensim në ato raste kur barra administrative për atë shtet është haptazi joproporcionale krahasuar me përfitimin që përftohet nga shteti kërkuar.

3. Nëse informacioni kërkohet nga shteti kërkuar në pajtim me këtë konventë, shteti i kërkuar përdor masat e tij për mbledhjen e informacionit për të përftuar informacionin e kërkuar, megjithëse shtetit të kërkuar mund të mos i duhet ky informacion për qëllimet e veta tatimore. Detyrimi që parashikohet në fjalinë pararendëse u nënshtrohet detyrimeve që gjenden në këtë konventë, por në asnjë rast ky kufizim, duke përfshirë veçanërisht ato të paragrafëve 1 dhe 2, nuk interpretohet sikur lejon shtetin e kërkuar të refuzojë dhënien e informacionit thjesht pasi nuk ka interes të brendshëm për këtë informacion.

4. Në asnjë rast dispozitat e kësaj konvente, duke përfshirë veçanërisht ato të paragrafëve 1 dhe 2, nuk interpretohen sikur lejojnë një shtet të kërkuar të refuzojë dhënien e informacionit vetëm pasi informacioni mbahet nga një bankë, një institucion tjetër financiar, person i emëruar ose që vepron në një agjenci apo në cilësi mirëbesimi apo pasi lidhet me interesa pronësie të një personi.

Neni 22

Fshehtësia

1. Çdo informacion i përftuar nga një Palë sipas kësaj konvente trajtohet si sekret dhe mbrohet në të njëjtën mënyrë si informacioni i përftuar sipas ligjit të brendshëm të asaj Pale dhe, në masën që është e nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, në pajtim me garancitë që mund të specifikohen nga Pala dhënëse sipas kërkesave të ligjit të saj të brendshëm.

2. Ky informacion në çdo rast u deklarohet vetëm personave ose autoriteteve (duke përfshirë gjykatat dhe organet administrative ose mbikëqyrëse përkatëse) të interesuara në vlerësimin, mbledhjen, ose përfitim, ekzekutimin ose ndjekjen penale në lidhje me, ose përcaktimin e ankimeve mbi tatimet e asaj Pale, ose mbikëqyrjen sa më sipër. Vetëm personat ose autoritetet e përmendura më sipër mund të përdorin informacionin dhe më pas vetëm për këto qëllime. Ato, pavarësisht dispozitave të paragrafit 1, mund ta deklarojnë në gjykime me dyer të hapura ose në vendimet gjyqësore në lidhje me këto tatime.

3. Nëse një Palë ka bërë një rezervë të parashikuar në nënparagrafin “a” të paragrafit 1 të nenit 30, çdo Palë tjetër që merr informacion nga ajo Palë nuk e përdor për qëllimin e një tatimi në kategorinë që i nënshtrohet rezerva. Në mënyrë të ngjashme, Palët që bëjnë një rezervë të tillë, nuk e përdorin informacionin e përftuar sipas kësaj konvente për qëllimet e një tatimi në kategorinë që i nënshtrohet rezervës.

4. Pavarësisht dispozitave të paragrafëve 1, 2 dhe 3, informacioni i marrë nga një Palë mund të përdoret për qëllime të tjera nëse ky informacion mund të përdoret për këto qëllime të tjera sipas ligjeve të Palës dhënëse dhe autoriteti kompetent i asaj Pale e autorizon këtë përdorim. Informacioni i dhënë nga një Palë një Pale tjetër mund t'i transmetohet nga kjo e fundit një Pale të tretë, duke iu nënshtruar autorizimit paraprak nga autoriteti kompetent i Palës së parë.

Neni 23 **Procedimet**

1. Procedimet në lidhje me masat e marra sipas kësaj konvente nga shteti i kërkuar paraqiten vetëm para organeve përkatëse të atij shteti.

2. Procedimet në lidhje me masat e marra sipas kësaj konvente nga shteti kërkuar, veçanërisht ato që, në fushën e kompensimit, lidhen me ekzistencën ose shumën e dëmit tatimor ose instrumentin që lejon ekzekutimin, paraqiten vetëm para organeve përkatëse të atij shteti. Nëse këto procedime fillojnë, shteti kërkuar informon shtetin e kërkuar, i cili pezullon procedurën në pritje të vendimit të organit në fjalë. Megjithatë, shteti i kërkuar, nëse i kërkohet nga shteti kërkuar, merr masa për ruajtjen për të garantuar kompensimin. Shteti i kërkuar mund të informohet gjithashtu për çdo gjykim nga një person i interesuar. Me marrjen e këtij informacioni, shteti i kërkuar, nëse është e nevojshme, konsultohet me shtetin kërkuar.

3. Sapo të jetë marrë një vendim në kuadrin e procedimit, shteti i kërkuar ose shteti kërkuar, sipas rastit, njofton shtetin tjetër për vendimin dhe implikimet që ka për kërkesën për ndihmë.

KAPITULLI V DISPOZITA TË VEÇANTA

Neni 24 **Zbatimi i konventës**

1. Palët komunikojnë me njëra-tjetrën për zbatimin e kësaj konvente nëpërmjet autoriteteve të tyre përkatëse. Autoritetet kompetente mund të komunikojnë drejtpërdrejt për këtë qëllim dhe mund të autorizojnë autoritetet e varura të veprojnë në emër të tyre. Autoritetet kompetente të dy ose më shumë Palëve mund të bien bashkërisht dakord mbi mënyrën e zbatimit të konventës ndërmjet tyre.

2. Nëse shteti i kërkuar është i mendimit që zbatimi i kësaj konvente në një rast të veçantë do të kishte pasoja serioze dhe të padëshirueshme, autoritetet kompetente të shtetit të kërkuar dhe kërkuar konsultohen me njëri-tjetrin dhe përpiqen të zgjidhin situatën me marrëveshje të përbashkët.

3. Një organ bashkërendues i përbërë nga përfaqësues të autoriteteve kompetente të Palëve monitoron zbatimin dhe zhvillimin e kësaj konvente, nën kujdesin e OECD-së. Për këtë qëllim, organi bashkërendues rekomandon çdo veprim që është i mundshëm për të zhvilluar më tej qëllimet e konventës. Në mënyrë të veçantë, ai vepron si forum për studimin e metodave dhe procedurave të reja për të rritur bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet tatimore dhe, sipas rastit, ai mund të rekomandojë rishikime ose ndryshime të konventës. Shtetet që e kanë nënshkruar por nuk e kanë ratifikuar, pranuar ose aprovuar konventën, kanë të drejtë të përfaqësohen në mbledhjet e organit bashkërendues si vëzhgues.

4. Një Palë mund t'i kërkojë organit bashkërendues të japë mendime mbi interpretimin e dispozitave të konventës.

5. Nëse lindin vështirësi ose dyshime ndërmjet dy ose më shumë Palëve në lidhje me zbatimin ose interpretimin e konventës, autoritetet kompetente të atyre Palëve përpiqen ta zgjidhin çështjen me marrëveshje të përbashkët. Marrëveshja i komunikohet organit bashkërendues.

6. Sekretari i Përgjithshëm i OECD-së informon Palët dhe shtetet nënshkruese që nuk e kanë ratifikuar, pranuar ose aprovuar ende konventën, në lidhje me opinionet e dhëna nga organi bashkërendues sipas dispozitave të paragrafit 4 të mësipërm dhe për marrëveshjet e përbashkëta të arritura në pajtim me paragrafin 5 të mësipërm.



Neni 25 Gjuha

Kërkesat për asistencë dhe përgjigjet për të, hartohen në një prej gjuhëve zyrtare të OECD-së dhe të Këshillit të Europës ose në një gjuhë tjetër të rënë dakord ndërmjet dy palëve ndërmjet shteteve kontraktuese përkatëse.

Neni 26 Shpenzimet

Përveç kur bihet dakord ndryshe ndërmjet dy Palëve përkatëse:

- a) shpenzimet e zakonshme të shkaktuara në dhënien e ndihmës mbulohen nga shteti i kërkuar;
- b) shpenzimet e jashtëzakonshme në dhënien e ndihmës mbulohen nga shteti kërkuar.

KAPITULLI VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 27 Marrëveshje ose masa të tjera ndërkombëtare

1. Mundësitë e ndihmës të parashikuara nga kjo konventë nuk kufizojnë, dhe as nuk kufizohen, nga ato që parashikohen në marrëveshjet ose masat e tjera të ardhshme ndërkombëtare ndërmjet Palëve përkatëse ose instrumenteve të tjera që lidhen me bashkëpunimin në çështjet tatimore.

2. Pavarësisht paragrafit 1, ato Palë që janë shtete anëtare të Bashkimit Europian mund të zbatojnë, në marrëdhëniet e tyre reciproke, mundësitë e asistencës së parashikuar nga konventa në masën që lejojnë një bashkëpunim më të gjerë se mundësitë e ofruara nga rregullat e zbatueshme në Bashkimin Europian.

Neni 28 Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi e konventës

1. Konventa është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe vendet anëtare të OECD-së. Ajo u nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose aprovimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit depozitohen te një nga depozitarët.

2. Kjo konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës në të cilën pesë shtete kanë shprehur pëlqimin e tyre t'i nënshtrohen konventës në pajtim me dispozitat e paragrafit 1.

3. Në lidhje me një shtet anëtar të Këshillit të Europës ose një vend anëtar të OECD-së që shpreh më vonë pëlqimin e tij t'i nënshtrohet asaj, konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose aprovimit.

4. Çdo shtet anëtar i Këshillit të Europës ose çdo vend anëtar i OECD-së që bëhet Palë në konventë pas hyrjes në fuqi të Protokollit që ndryshon këtë konventë, të hapur për nënshkrim më 27 maj 2010 (Protokollit i vitit 2010) bëhet Palë në konventë sipas ndryshimit të Protokollit, përveç kur ata shprehin një synim tjetër në një komunikim me shkrim drejtuar një prej depozitarëve.

5. Pas hyrjes në fuqi të Protokollit të vitit 2010, çdo shtet që nuk është anëtar i Këshillit të Europës ose i OECD-së, mund të kërkojë të ftohet për të nënshkruar dhe ratifikuar këtë konventë me ndryshimin e Protokollit të vitit 2010. Çdo kërkesë për këtë qëllim i drejtohet një prej depozitarëve, i cili ia transmeton atë Palëve. Depozitari informon gjithashtu Komitetin e Ministrave të Këshillit të Europës dhe Këshillin e OECD-së. Vendimi për të ftuar shtetet, të cilat bëjnë kërkesë të bëhen Palë në këtë konventë merret me konsensus nga Palët në konventë nëpërmjet organit bashkërendues. Në lidhje me çdo

shtet që ratifikon konventën me ndryshimin e Protokollit 2010 në pajtim me këtë paragraf, kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit të një prej depozitarëve.

6. Dispozitat e kësaj konvente, me ndryshimin e Protokollit 2010, kanë efekt për ndihmën administrative në lidhje me afatet tatimore që fillojnë pas datës 1 janar të vitit pas atij në të cilin konventa, e ndryshuar me Protokollin e vitit 2010, ka hyrë në fuqi në lidhje me një Palë, ose nëse nuk ka periudhë tatimore, për ndihmën administrative në lidhje me vendosjen e tatimeve më ose pas datës 1 janar të vitit pas atij në të cilin konventa, e ndryshuar me Protokollin 2010, ka hyrë në fuqi në lidhje me një Palë. Çdo dy ose më shumë Palë mund të bien dakord bashkërisht që konventa, e ndryshuar me Protokollin e vitit 2010, të ketë efekt për ndihmën administrative në lidhje me afatet tatimore ose vendosjen e mëparshme të tatimeve.

7. Pavarësisht paragrafit 6, për çështjet tatimore që lidhen me sjellje të qëllimshme që i nënshtrohen ndjekjes penale sipas ligjeve penale të Palës kërkuese, dispozitat e kësaj konvente, me ndryshimin e Protokollit të vitit 2010, kanë efekt nga data e hyrjes në fuqi në lidhje me një Palë për periudhat tatimore ose vendosjen e mëparshme të tatimeve.

Neni 29

Zbatimi territorial i konventës

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose gjatë depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose aprovimit, specifikon territorin ose territoret në të cilat zbatohet kjo konventë.

2. Çdo shtet, në një datë të mëvonshme, me deklaratë drejtuar një depozitari, mund të zgjerojë zbatimin e kësaj konvente në çdo territor tjetër të specifikuar në deklaratë. Në lidhje me këtë territor, konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së kësaj deklaratë nga depozitari.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas njërit prej dy paragrafëve të mësipërm, në lidhje me një territor të specifikuar në këtë deklaratë, mund të tërhiqet me një njoftim drejtuar një prej depozitarëve. Tërheqja hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga depozitari.

Neni 30

Rezervat

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose aprovimit ose në një datë të mëvonshme, deklaron që rezervon të drejtën:

a) për të mos dhënë asnjë formë ndihme në lidhje me tatimet Palëve të tjera në çdo kategori të renditur në nënparagrafin “b” të paragrafit 1 të nenit 2, me kusht që të mos jetë përfshirë në ndonjë tatim të brendshëm në atë kategori sipas aneksit A të konventës;

b) për të mos dhënë ndihmë për kompensimin e çdo dëmi tatimor ose në kompensimin e një gjobe administrative, për të gjitha tatimet ose për tatimet e një ose më shumë kategorive të renditura në paragrafin 1 të nenit 2;

c) për të mos dhënë ndihmë në lidhje me çdo dëm tatimor, i cili ekziston në datën e hyrjes në fuqi të kësaj konvente në lidhje me atë shtet, ose nëse është bërë më parë një rezervë sipas nënparagrafit “a” ose “b” më sipër, në datën e tërheqjes së kësaj rezerve në lidhje me tatimet në kategorinë në fjalë;

d) për të mos dhënë ndihmë në dorëzimin e dokumenteve për të gjitha tatimet ose vetëm për tatimet në një ose më shumë prej kategorive të renditura në paragrafin 1 të nenit 2;

e) për të mos lejuar dorëzimin e dokumenteve me postë sipas parashikimit në paragrafin 3 të nenit 17;

f) për të zbatuar paragrafin 7 të nenit 28 ekskluzivisht për ndihmën administrative në lidhje me periudhat tatimore që fillojnë më ose pas datës 1 janar të vitit të tretë para atij në të cilin ka hyrë në fuqi konventa, me ndryshimin e Protokollit të vitit 2010 në lidhje me një Palë, ose nëse nuk ka periudhë



tatimore, për ndihmën administrative në lidhje me vendosjen e tatimeve që janë më ose pas datës 1 janar të vitit të tretë para atij në të cilin ka hyrë në fuqi konventa, me ndryshimin e Protokollit të vitit 2010 në lidhje me një Palë.

2. Nuk mund të bëhet rezervë tjetër.

3. Pas hyrjes në fuqi të konventës në lidhje me një Palë, kjo Palë mund të bëjë një ose më shumë rezerva të renditura në paragrafin 1, të cilat ajo nuk i ka bërë në kohën e ratifikimit, pranimit ose aprovimit. Këto rezerva hyjnë në fuqi në ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së rezervave nga një prej depozitarëve.

4. Secila Palë që ka bërë një rezervë sipas paragrafëve 1 dhe 3 mund ta tërheqë atë plotësisht ose pjesërisht nëpërmjet një njoftimi drejtuar një prej depozitarëve. Tërheqja hyn në fuqi në datën e marrjes së këtij njoftimi nga depozitari në fjalë.

5. Një Palë që ka bërë një rezervë në lidhje me një dispozitë të kësaj konvente nuk mund të kërkojë zbatimin e asaj dispozite nga një Palë tjetër; megjithatë, nëse rezerva është e pjesshme, ajo mund të kërkojë zbatimin e asaj dispozite në masën që e ka pranuar atë.

Neni 31 Denoncimi

1. Secila Palë mund të denoncojë në çdo kohë këtë konventë nëpërmjet një njoftimi drejtuar një prej depozitarëve.

2. Ky njoftim hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga depozitari.

3. Secila Palë që denoncon këtë konventë mbetet e detyruar nga dispozitat e nenit 22 për sa kohë mban në zotërim dokumente ose informacion të përfutur nga kjo konventë.

Neni 32 Depozitarët dhe funksionet e tyre

1. Depozitari me të cilin është kryer një veprim, njoftim apo komunikim, njofton shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe vendet anëtare të OECD-së dhe çdo Palë në këtë konventë për:

- a) çdo nënshkrim;
- b) depozitimim e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi ose aprovimi;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj konvente në pajtim me dispozitat e neneve 28 dhe 29;
- d) çdo deklaram të bërë në pajtim me dispozitat e paragrafëve 3 të nenit 4 ose paragrafit 3 të nenit 9 dhe tërheqjen e këtij deklarimi;
- e) çdo rezervë të bërë në pajtim me dispozitat e nenit 30 dhe tërheqjen e çdo rezerve të kryer në pajtim me dispozitat e paragrafit 4 të nenit 30;
- f) çdo njoftim të marrë në pajtim me dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 të nenit 2, paragrafit 3 të nenit 3, nenit 29 ose paragrafit 1 të nenit 31;
- g) çdo veprim, njoftim ose komunikim tjetër në lidhje me këtë konventë.

2. Depozitari që merr një komunikim ose bën një njoftim në zbatim të dispozitave të paragrafit 1, njofton për këtë menjëherë depozitarin tjetër.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë për këtë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë konventë.

Bërë nga depozitarët në datën 1 qershor 2011 në pajtim me nenin X.4 të Protokollit ndryshues të Konventës për Ndihmën Administrative të Ndërsjellë në Çështjet Tatimore, në anglisht dhe frëngjisht, ku të dyja tekstet janë njëloj autentike, në dy kopje nga të cilat njëra depozitohet në arkivat e depozitarit. Depozitarët i transmetojnë secilës Palë dhe çdo shteti që ka të drejtë të bëhet palë, një kopje të vërtetuar të konventës të ndryshuar nga Protokollit.

LIGJ
Nr. 147/2013

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCEVE, DHE ARTIGIANCASSA S. P. A. PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT TË
NDIHMËS SË INTEGRUAR PËR ZHVILLIMIN E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË
MESME SHQIPTARE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Artigiancassa S. p. A. për financimin e programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 6.5.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8184, datë 21.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

F.ROT./NDIHMË 11/006/00

MARRËVESHJE FINANCIARE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE DHE ARTIGIANCASSA S.P.A.**

15.000.000,00 EURO

**“PROGRAMI I ASISTENCËS SË INTEGRUAR PËR ZHVILLIMIN E SME-VE
SHQIPTARE”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përfaqësuar nga Ministria e Financave (prej këtu e më poshtë i quajtur “Huamarrësi”), nga njëra anë dhe Artigiancassa S.p.A., anëtare e grupit bankar Banca Nazionale del Lavoro, e regjistruar në Regjistrin e Bankave, kapitali aksionar 6.300.000,00 euro me seli në Romë, Via Crescenzo del Monte 25, regjistruar në Regjistrin e Shoqërive, kodi tatimor VAT nr. 10251421003 (prej këtu e më poshtë i quajtur “Artigiancassa”), si administratore, në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Italisë, e Fondit Qarkullues të Bashkëpunimit për Zhvillimin, të themeluar me nenin 26 të ligjit italian nr. 227, datë 24 maj 1977, dhe më tej të parashikuar në nenin 6 të ligjit italian nr. 49, datë 26 shkurt 1987, të përfaqësuar nga z. Stefano Gatti, shef i njësisë së menaxhimit të Fondit Qarkullues nga ana tjetër (Artigiancassa dhe Huamarrësi së bashku prej këtu e më poshtë të quajtura “Palët”),

kanë vendosur të lidhin këtë marrëveshje financiare.



Neni 1 Përkufizime

Në marrëveshjen financiare dhe në anekset e saj, termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

- “Njohja e borxhit” është deklarata, e parashikuar në nenin 11, nëpërmjet së cilës Huamarrësi merr përsipër, në favor të Artigiancassa, të rimburojë shumën principale të kërkueshme në lidhje me huan e butë;

- “AGF” është Fondi Shqiptar i Garancisë i financuar me komponentin e huas së butë prej 2.500.000,00 eurosh (dy milionë e pesëqind mijë/00) të dhënë Qeverisë së Shqipërisë dhe kredituar në një llogari të veçantë të hapur nga Huamarrësi në Bankën e Shqipërisë. AGF-ja mund të përdoret me qëllim që të zvogëlohen garancitë e kërkuara për SME-të nga bankat tregtare lokale private;

- “Marrëveshja” është kjo marrëveshje financiare, preambula dhe anekset e së cilës përbëjnë pjesë integrale të saj;

- “AID 06/004/00” është huaja e butë prej 27.500.000,00 eurosh (njëzet e shtatë milionë e pesëqind mijë/00), që synon financimin e zhvillimit të sektorit privat shqiptar nëpërmjet mbështetjes së SME-ve dhe asistencës teknike përkatëse. Huaja e butë ndahet në një shumë prej 25.000.000,00 eurosh (njëzet e pesë milionë/00) për financimin e projekteve të SME-ve, dhe në një shumë prej 2.500.000,00 eurosh (dy milionë e pesëqind mijë/00) për themelimin e AGF-së;

- “Shoqëri Auditimi” është një shoqëri auditimi tepër e kualifikuar, e rëndësishme ndërkombëtare. Shoqëria audituese do të përzgjidhet dhe ngarkohet nga METE me detyrën e auditimit të dokumenteve financiare dhe administrative, dhe procedurave në lidhje me programin sipas parashikimit në nenin 5;

- “Llogaria e Banca Nazionale del Lavoro S.p.A.” është llogaria (IBAN: IT29U0100503214000000250013–BIC BNLIITRR), e hapur te Banca Nazionale del Lavoro S.p.A., në emër të Artigiancassa/Gestione Fondo Rotativo L.49/87 - Ministero Economia e Finanze, në të cilën Huamarrësi do të shlyejë borxhin e tij;

- “CLSC” është Komiteti Drejtues i Linjës së Kredisë, aktiviteti i të cilit është përshkruar në marrëveshjen e programit;

- “Raport financiar” është raporti financiar, i aprovuar nga Shoqëria Audituese, i lëshuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë (METE) dhe i aprovuar nga Shoqëria Audituese;

- “Periudha e faljes” është periudha që zgjat 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) muaj, duke filluar nga data e kreditimit të kështit të parë të huas së butë;

- “Autoritetet kompetente italiane” janë Ministria e Ekonomisë dhe Financës dhe/ose Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Italisë dhe/ose çdo ent tjetër kompetent i Qeverisë së Republikës së Italisë, të caktuar për qëllimin e kësaj marrëveshjeje;

- “MAE/DGCS” është Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Italisë – Drejtoria e Përgjithshme e Bashkëpunimi për Zhvillim;

- “MEF” është Ministria e Ekonomisë dhe Financës së Republikës së Italisë;

- “METE” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë;

- “PA” është Marrëveshja e Programit e nënshtruar më ... në ... ndërmjet Qeverisë së Republikës së Italisë, e përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për realizimin e programit;

- “PLCB” janë bankat tregtare lokale private që mbi bazën e një marrëveshjeje huadhënieje me METE-n financojnë SME-të;

- “Programi” është programi i asistencës së integruar për zhvillimin e NVM-ve shqiptare, që duhet të financohen nga huaja e butë në përputhje me marrëveshjen e programit dhe këtë marrëveshje;

- “SME-të” janë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, projektet e të cilave do të financohen me komponentin e huas së butë prej 11.000.000,00 eurosh (njëmbëdhjetë milionë/00);

- “Hua e butë” është financimi që Artigiancassa, mbi bazën e autorizimit të lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe me propozim të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Italisë, do të japë me termat dhe kushtet e parashikuara në nenin 3 të kësaj marrëveshjeje. Huaja e butë ndahet në një shumë prej 11.000.000,00 (njëmbëdhjetë milionë/00) eurosh për financimin e projekteve të SME-ve shqiptare, në një shumë prej 2.500.000,00 eurosh (dy milionë e pesëqind mijë/00) për financimin e AGF-së dhe 1.500.000,00 (një milion e pesëqind mijë/00) për financimin e asistencës teknike;

- “Llogari e veçantë” është llogaria/të e veçantë/a të hapura nga Huamarrësi te Banka e Shqipërisë, në të cilën do të kreditohet huaja e butë me këste dhe pas kësaj transferohet në PLCB. Shuma prej 11.000.000,00 (njëmbëdhjetë milionë/00) eurosh do të kreditohet në një llogari të veçantë përkatëse për financimin e projekteve të SME-ve shqiptare, shuma prej 2.500.000,00 eurosh (dy milionë e pesëqind mijë/00) për financimin e AGF-së në një llogari të veçantë të ndryshme dhe shuma prej 1.500.000,00 (një milion e pesëqind mijë/00) në një tjetër llogari të veçantë për financimin e asistencës teknike;

- “Kontratë/a furnizimi” janë kontrata/t tregtare në lidhje me furnizimin me mallra dhe/ose shërbime në lidhje me realizimin e programit.

Neni 2 Preambulë

2.1 Njëpërmjet PA-së, të nënshkruar më ... në ... ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, kjo e fundit ka marrë përsipër të financojë programin njëpërmjet një huaje të butë deri në një shumë maksimale prej 15.000.000,00 euro (pesëmbëdhjetë milionë/00).

2.2 Njëpërmjet kësaj marrëveshjeje, Palët synojnë: i) të zbatojnë dispozitat financiare në lidhje me huan e butë sipas parashikimit në nenet 3 dhe 4 të PA-së; dhe ii) të rregullojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre në përputhje me PA-në.

2.3 Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Qeverisë së Republikës së Italisë, me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Italisë, me dekretin nr. 90 428, datë 15 nëntor 2011, ka autorizuar Artigiancassa t'i japë Huamarrësit një kredi të butë me termat dhe kushtet e parashikuara në nenin 3 të kësaj marrëveshjeje (prej këtu e më poshtë e quajtur “hua e butë”) për qëllimin e financimit të programit.

Neni 3 Huaja e butë

3.1 Artigiancassa i jep Huamarrësit, dhe Huamarrësi pranon, huan e butë me kushtet e mëposhtme:

- Shuma: 15.000.000,00 euro (pesëmbëdhjetë milionë/00);
- Kohëzgjatja: 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet;
- Periudha pa pagesë principali: 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) muaj, duke filluar nga data e disbursimit të parë;

- Shlyerja: 16 (gjashtëmbëdhjetë) këste të njëpasnjëshme, të shpërndara në mënyrë të barabartë, gjysmëvjeçare të principalit, i pari prej të cilëve është 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) muaj pas disbursimit të parë;

- Norma e interesit: 0.00% p.a. (zero pikë zero p.a.);

- Qëllimi i kredisë: “Programi i asistencës së integruar për zhvillimin e SME-ve shqiptare”. Huaja e butë ndahet në një shumë prej 11.000.000,00 (njëmbëdhjetë milionë/00) euro për financimin e projekteve të SME-ve shqiptare, një shumë prej 2.500.000,00 eurosh (dy milionë e pesëqind mijë/00) për



financimin e AGF-së dhe 1.500.000,00 (një milion e pesëqind mijë/00) për financimin e asistencës teknike.

3.2 Huaja e butë do të përdoret për blerjen e mallrave dhe shërbimeve me origjinë italiane. Për sa i takon komponentit të huas së butë prej 11.000.000,00 eurosh (njëmbëdhjetë milionë/00): 1) deri në 60% (për qind) të shumës së çdo huaje për projektet nga 15.000,00 eurosh (pesëmbëdhjetë mijë/00) deri në 50.000,00 euro (pesëdhjetë mijë/00) mund të përdoren të mbulojnë kostot lokale ose nga vende të tjera fqinje në zhvillim; 2) deri në 30% (tridhjetë për qind) të shumës së çdo huaje për projektet nga 50.000,00 euro (pesëdhjetë mijë/00) deri në 500.000,00 euro (pesëqind mijë/00) mund të përdoren për të mbuluar kostot lokale ose nga vende të tjera fqinje në zhvillim.

Kontratat e furnizimit përcaktohen në euro ose në monedhën shqiptare.

3.3 Huaja e butë nuk mund të përdoret për të financuar:

- taksat lokale, detyrimet doganore, TVSH-në;
- investimet në sektorin e kohës së lirë, pasuri të paluajtshme, armë, drogë dhe pije alkoolike, duhan dhe nënprodukte, prodhimin dhe produktet e ndaluara nga vendet e Bashkimit Europian për import dhe eksport, mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare.

3.4 Huaja e butë është e disponueshme në përputhje me termat dhe kushtet e parashikuara në këtë marrëveshje.

3.5 Kredia për financimin e projekteve të SME-ve shqiptare do të disbursohet në dy këste në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 7; kredia për financimin e AGF-së do të disbursohet në një këst në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 8; kredia për financimin e asistencës teknike do të disbursohet në një këst në përputhje me procedurat e parashikuara në nenin 9.

3.6 Interesat e mbledhura mbi paratë e mbajtura në llogarinë/të e veçantë do të përdoren për financimin e programit.

Neni 4

Hyrja në fuqi e marrëveshjes financiare

4.1 Kjo marrëveshje hyn në fuqi pasi Artigiancassa të ketë marrë dokumentet e mëposhtme:

a) nga Huamarrësi:

i) një deklaratë nga autoriteti kompetent i Qeverisë së Shqipërisë, që tregon autoritetin e Huamarrësit për të nënshkruar, në emër dhe për llogari të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, këtë Marrëveshje nga një person i autorizuar rregullisht në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi të plotë në Republikën e Shqipërisë dhe për të ndërmarrë detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje;

ii) emërimi me shkrim nga autoriteti kompetent i Huamarrësit (nëpërmjet Ambasadës Italiane në Republikën e Shqipërisë) të personit ose personave të autorizuar rregullisht për të nënshkruar këtë marrëveshje, kërkesën e disbursimit në formatin e aneksit A dhe njohjen e borxhit në formatin e aneksit B, të përmendur në nenin 11 më poshtë. Ky emërim specifikon emrin dhe postin e këtij personi/ave dhe përmban “ekzemplarin” e përditësuar të nënshkrimeve të tyre. Çdo modifikim i tyre (sipas rastit) i transmetohet Artigiancassa-s në kohën e duhur nga Huamarrësi;

iii) marrjen e komunikimit nga METE, nëpërmjet MAE-DGCS, në lidhje me përzgjedhjen e Shoqërisë së Auditimit;

iv) një deklaram që certifikon hapjen e llogarisë së veçantë sipas specifikimit në përkufizime;

b) nga MAE-DGCS:

v) “moskundërshtimin” përkatës të MAE-DGCS drejtuar METE-s mbi emërimin e Shoqërisë së Auditimit të përzgjedhur në përputhje me dispozitat e nenit 5.

4.2 Artigiancassa, me marrjen plotësisht të pranueshme të dokumenteve të sipërpërmendura, do të njoftojë Huamarrësin dhe MAE-DGCS, me letër ose faks që më pas duhet të konfirmohet me letër, datën në të cilën hyn në fuqi kjo marrëveshje.

Neni 5 **Shoqëria audituese**

5.1 METE i ngarkon një Shoqërie Audituese, sipas nenit 5.2, detyrën e kryerjes së auditimit të operacioneve në lidhje me huan e butë.

5.2 Kontrata ndërmjet METE-s dhe Shoqërisë së Auditimit i paraqitet për aprovim MAE-DGCS para nënshkrimit.

5.3 Shoqëria e Auditimit përcakton një format standard të raportit financiar të audituar. Ky format duhet të aprovohet nga METE dhe Artigiancassa mbi bazën e aktiviteteve të rregulluara në PA dhe në këtë marrëveshje, dhe i dërgohet MAE-DGCS-së dhe për dijeni Artigiancassa-s nga METE.

5.4 Raporti financiar i audituar: i) ka të bëjë me raportet financiare dhe teknike të dërguara nga METE Artigiancassa-s dhe MAE-DGCS-së, dhe ii) merr parasysh rregullshmërinë dhe përmbushjen e kushteve të vendosura në këtë marrëveshje të çdo veprimi financiar në lidhje me huan e butë.

5.5 Shoqëria e auditimit nxjerr raporte financiare të audituara, në përputhje me nenet 7, 8 dhe 9 dhe duhet të aprovohen nga MAE-DGCS dhe Artigiancassa.

Neni 6 **Afati i disbursimit të huas së butë**

6.1 Afati i disbursimit të huas së butë skadon 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj pas datës së disbursimit të parë. Ky afat mund të shtyhet nga Artigiancassa vetëm pas kërkesës së Huamarrësit. Artigiancassa nuk mund të shtyjë afatin e disbursimit në rast se Huamarrësi ose autoritetet kompetente italiane nuk bien dakord me një shtyrje të tillë dhe nuk kanë njoftuar me shkrim Artigiancassa të paktën 30 (tridhjetë) ditë para datës së skadimit të afatit të disbursimit.

6.2 Në rast se afati i disbursimit ka skaduar dhe nuk mund të shtyhet, Artigiancassa, pasi të jetë konsultuar me autoritetet kompetente italiane, informon Huamarrësin për anulimin e angazhimit të Artigiancassa-s në lidhje me fondet e papërdorura.

Neni 7 **Kushtet dhe modalitetet për disbursimin e huas së butë për financimin e projekteve të SME-ve shqiptare**

7.1 Pasi kjo marrëveshje të ketë hyrë në fuqi dhe pas konfirmimit nga Huamarrësi drejtuar Artigiancassa-s në lidhje me aftësinë për punë të organeve për zbatimin e programit të përmendur në PA, Artigiancassa ekzekuton kërkesat e disbursimit, në përputhje me dispozitat e specifikuar këtu. Shuma e huas së butë do të alokohet në dy këste: i pari 5.500.000,00 euro (pesë milionë e pesëqind mijë/00), i dyti 5.500.000,00 euro (pesë milionë e pesëqind mijë/00) në llogarinë e veçantë të hapur nga Huamarrësi në Bankën e Shqipërisë. Interesi që del nga llogaria e veçantë grumbullohet dhe përdoret për financimin e programit.

7.2 Secila kërkesë disbursimi ekzekutohet brenda 30 (tridhjetë) ditësh, duke filluar nga data e marrjes së kërkesës nga Artigiancassa.

7.3 Kërkesa e parë për disbursim, e transmetuar nga METE, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, në përputhje me aneksin A për shumën e 5.500.000,00 eurove (pesë milionë e pesëqind mijë/00), do të kreditohet pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje dhe marrjes nga MAE-DGCS të komunikimit prej Huamarrësit në lidhje me ngritjen dhe aftësinë për punë të organeve për zbatimin e programit. Komunikimi i mësipërm duhet t'i dërgohet për dijeni nga MAE-DGCS-ja Artigiancassa-s.

7.4 Kërkesa e dytë për disbursim, e transmetuar nga METE, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, në përputhje me aneksin A për shumën e 5.500.000,00 eurove (pesë milionë e pesëqind mijë/00), do të kreditohet pas angazhimit të të paktën 80% (tetëdhjetë për qind) të shumës së kështit të parë, dhe pas verifikimit e aprovimit nga MAE-DGCS dhe Artigiancassa të raportit financiar të audituar të përgatitur nga METE dhe të aprovuar nga Shoqëria e Auditimit. Raporti financiar i audituar do t'i



bashkëngjitet aneksit A dhe do të përmbajë detaje mbi vlefshmërinë e çdo kontrate. MAE-DGCS dhe Artigiancassa do të informojnë Huamarrësin dhe METE-n në lidhje me rezultatet e verifikimit brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e marrjes së raportit financiar të audituar. Në rast se Shoqëria e Auditimit vë në dukje parregullsi, Artigiancassa, në bashkëpunim me MAE-DGCS-në, do të ngurtësojë disbursimin e kështit të dytë. Vetëm pas shpjegimit të këtyre parregullsive nga Shoqëria e Auditimit dhe METE, do të lejohet disbursimi i kështit të dytë.

7.5 Nëse disa shpenzime të përfshira në raportin financiar të audituar nuk aprovohen nga Shoqëria e Auditimit, dhe/ose nga MAE-DGCS-ja dhe Artigiancassa, kësti i dytë çlirohet vetëm pasi llogaria e veçantë të jetë plotësuar nga METE, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, me një shumë të barabartë me shpenzimet që nuk janë aprovuar.

7.6 Pasi shuma e përgjithshme e disbursuar sipas kështit të parë dhe të dytë është angazhuar për një shumë më të madhe se 9.000.000,00 euro (nëntë milionë/00), METE, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, do t'i dërgojë MAE-DGCS-së dhe Artigiancassa-s një raport financiar të audituar të përgatitur vetë dhe të aprovuar nga Shoqëria e Auditimit. MAE-DGCS dhe Artigiancassa do të informojnë Huamarrësin dhe METE-n në lidhje me rezultatet e verifikimit brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e marrjes së raportit financiar të audituar.

7.7 Nëse disa shpenzime të përfshira në raportin financiar të audituar nuk aprovohen nga Shoqëria e Auditimit, dhe/ose nga MAE-DGCS-ja dhe Artigiancassa, METE, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, do ta plotësojë llogarinë e veçantë me një shumë të barabartë me shpenzimet që nuk janë aprovuar.

7.8 Pasi të gjitha fondet e disbursuara të jenë angazhuar dhe disbursuar, METE, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, do t'i dërgojë MAE-DGCS-së dhe Artigiancassa-s një raport përfundimtar financiar të audituar, të përgatitur vetë dhe të aprovuar nga Shoqëria e Auditimit. MAE-DGCS dhe Artigiancassa do të informojnë Huamarrësin dhe METE-n në lidhje me rezultatet e verifikimit brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e marrjes së raportit financiar të audituar.

7.9 Huamarrësi, nëpërmjet METE-s, merr përsipër në mënyrë të pakthyeshme t'i rikthejë Artigiancassa-s shumat e barabarta me shpenzimet që nuk janë aprovuar nga Shoqëria e Auditimit dhe/ose që nuk janë aprovuar nga MAE-DGCS-ja dhe Artigiancassa.

7.10 Nëse një shumë e kredituar Huamarrësit nga Artigiancassa nuk përdoret brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga data e disbursimit të fundit, kjo shumë do t'i kthehet menjëherë Artigiancassa-s nga METE, në emër dhe për llogari të Huamarrësit. Ky transferim do të bëhet pa vonesë pas komunikimit, të rënë dakord nga MAE-DGCS-ja, nga Artigiancassa drejtuar Huamarrësit dhe METE-s dhe gjithmonë brenda një muaji nga komunikimi i Artigiancassa-s.

7.11 Pas disbursimit të parë të fondeve në llogarinë e veçantë, Artigiancassa i transmeton Huamarrësit me letër, grafikun e shlyerjes për shumën e disbursuar, duke treguar datat e pagesave në lidhje me to. Pas disbursimit të dytë të fondit, Artigiancassa i transmeton Huamarrësit grafikun e shlyerjes për shumën e disbursuar. Çdo grafik shlyerjeje, i plotësuar në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 10, do të pranohet nga Huamarrësi me shkrim.

Neni 8

Kushtet dhe modalitetet për disbursimin e huas së butë për financimin e AGF-së

8.1 Pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje dhe pas të paktën 18 (tetëmbëdhjetë) muajsh nga fillimi i aktiviteteve të AGF-së, sipas huas së butë AID 06/004/00, Artigiancassa do të ekzekutojë kërkesën për disbursim, në përputhje me dispozitat e specifikuara këtu. Shuma e huas së butë do të alokohet në një kësht prej 2.500.000,00 eurosh (dy milionë e pesëqind mijë euro/00) në një llogari të veçantë të dedikuar të hapur nga Huamarrësi te Banka e Shqipërisë. Interesi që del nga llogaria e veçantë mbledhet dhe përdoret për financimin e programit.

8.2 Kërkesa për disbursim ekzekutohet brenda 30 (tridhjetë) ditësh duke filluar nga data e marrjes së kërkesës nga Artigiancassa.

8.3 Kërkesa për disbursim, e transmetuar nga METE, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, në përputhje me aneksin A për shumën e 2.500.000,00 eurove (dy milionë e pesëqind mijë/00), do të kreditohet pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje dhe marrjes nga MAE-DGCS të komunikimit prej Huamarrësit në lidhje me konfirmimin që AGF-ja ka filluar veprimtarinë prej të paktën 18 muajsh. Komunikimi i mësipërm i Huamarrësit duhet t'i dërgohet për dijeni nga MAE-DGCS-ja Artigiancassa-s.

8.4 Kërkesa për disbursim do të përfshijë një raport financiar të audituar të përgatitur nga METE dhe të aprovuar nga Shoqëria e Auditimit në lidhje me: i) vlefshmërinë e çdo operacioni garancie të financuar nga AGF-ja; dhe ii) skemën e menaxhimit të AGF-së në rastin e modifikimeve nga skema e aprovuar nga CLSC-ja dhe MAE-DGCS-ja, sipas huas së butë AID 06/004/00.

MAE-DGCS dhe Artigiancassa do të informojnë Huamarrësin dhe METE-n në lidhje me rezultatet e verifikimit brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e marrjes së raportit financiar të audituar.

Në rast se Shoqëria e Auditimit vë në dukje parregullsi, Artigiancassa, në bashkëpunim me MAE-DGCS-në, do të ngurtësojë disbursimin. Vetëm pas shpjegimit të këtyre parregullsive nga Shoqëria e Auditimit dhe METE, do të lejohet disbursimi.

8.5 Nëse disa operacione të garancisë të përfshira në raportin financiar të audituar, nuk aprovohen nga Shoqëria e Auditimit, dhe/ose nuk aprovohen nga MAE-DGCS-ja dhe Artigiancassa, disbursimi do të lejohet vetëm pasi llogaria e veçantë të jetë plotësuar nga METE, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, me një shumë të barabartë me shpenzimet që nuk janë aprovuar.

8.6 Pas përdorimit të shumës së përgjithshme të disbursuar dhe, në çdo rast, brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga data e disbursimit, METE, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, i dërgon MAE-DGCS-së dhe Artigiancassa-s një raport final financiar të audituar të përgatitur nga METE dhe të aprovuar nga Shoqëria e Auditimit. MAE-DGCS dhe Artigiancassa do të informojnë Huamarrësin dhe METE-n në lidhje me rezultatet e verifikimit brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e marrjes të raportit financiar të audituar.

8.7 Huamarrësi, nëpërmjet METE-s, merr përsipër në mënyrë të pakthyeshme t'i rikthejë Artigiancassa-s shumën e barabarta me operacionet e garancisë, që nuk janë aprovuar nga Shoqëria e Auditimit dhe/ose që nuk janë aprovuar nga MAE-DGCS-ja dhe Artigiancassa.

8.8 Nëse një shumë e kredituar Huamarrësit nga Artigiancassa nuk përdoret brenda 24 (njëzet e katër) muajve nga data e disbursimit, kjo shumë, do t'i kthehet menjëherë Artigiancassa-s nga METE, në emër dhe për llogari të Huamarrësit. Kjo transfertë do të bëhet pa vonesë pas komunikimit, të rënë dakord nga MAE-DGCS-ja, nga Artigiancassa drejtuar Huamarrësit dhe METE-s, dhe detyrimisht, brenda një muaji nga komunikimi i Artigiancassa-s.

8.9 Pas disbursimit të fondeve në llogarinë e veçantë, Artigiancassa i transmeton Huamarrësit me letër, grafikun e shlyerjes për shumën e disbursuar, duke treguar datat e pagesave në lidhje me to. Grafiku i shlyerjes, i plotësuar në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 10, do të pranohet nga Huamarrësi me shkrim.

Neni 9

Kushtet dhe modalitetet për disbursimin e huas së butë për financimin e asistencës teknike

9.1 Pasi kjo marrëveshje të ketë hyrë në fuqi dhe pas konfirmimit nga Huamarrësi drejtuar Artigiancassa-s në lidhje me aftësinë për punë të organeve për zbatimin e programit të përmendur në PA, Artigiancassa do të ekzekutojë kërkesën e disbursimit, në përputhje me dispozitat e specifikuar këtu. Shuma e huas së butë do të alokohet në një kësht prej 1.500.000,00 eurosh (një milion e pesëqind mijë euro/00) në një llogari të veçantë të dedikuar të hapur nga Huamarrësi te Banka e Shqipërisë. Interesi që del nga llogaria e veçantë mbledhet dhe përdoret për financimin e programit.

9.2 Kërkesa për disbursim ekzekutohet brenda 30 (tridhjetë) ditësh duke filluar nga data e marrjes së kërkesës nga Artigiancassa.

9.3 Kërkesa për disbursim, e transmetuar nga METE, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, në përputhje me aneksin A për shumën e 1.500.000,00 eurove (një milion e pesëqind mijë/00), do të



kreditohet pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje dhe pas konfirmimit nga Huamarrësi kundrejt Artigiancassa-s në lidhje me aftësinë për punë të organeve për zbatimin e programit të përmendur në PA.

9.4 METE do t'i transmetojë MAE-DGCS-së dhe Artigiancassa-s, çdo vit dhe gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit që nga data e disbursimit, një raport financiar të audituar të përgatitur nga METE dhe të aprovuar nga Shoqëria e Auditimit dhe të nënshkruar nga CLSC-ja. MAE-DGCS dhe Artigiancassa do të informojnë Huamarrësin dhe METE-n në lidhje me rezultatet e verifikimit brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e marrjes të raportit financiar të audituar.

9.5 Nëse disa shpenzime të përfshira në raportin financiar të audituar nuk aprovohen nga Shoqëria e Auditimit, dhe/ose nuk aprovohen nga MAE-DGCS-ja dhe Artigiancassa, METE, në emër dhe për llogari të Huamarrësit, merr përsipër në mënyrë të pakthyeshme të kompensojë Artigiancassa-n me shumat e barabarta me shpenzimet që nuk janë aprovuar nga Shoqëria e Auditimit, dhe/ose nuk janë aprovuar nga MAE-DGCS-ja dhe Artigiancassa.

9.6 Nëse një shumë e kredituar Huamarrësit nga Artigiancassa nuk përdoret brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga data e disbursimit, kjo shumë i kthehet menjëherë Artigiancassa-s nga METE, në emër dhe për llogari të Huamarrësit. Kjo transfertë bëhet pa vonesë pas komunikimit, të rënë dakord nga MAE-DGCS-ja, nga Artigiancassa drejtuar Huamarrësit dhe METE-s, dhe detyrimisht, brenda një muaji nga komunikimi i Artigiancassa-s.

9.7 Pas disbursimit të fondeve në llogarinë e veçantë, Artigiancassa do t'i transmetojë Huamarrësit me letër, grafikun e shlyerjes për shumën e disbursuar, duke treguar datat e pagesave në lidhje me to. Grafiku i shlyerjes, i plotësuar në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 10, do të pranohet nga Huamarrësi me shkrim.

Neni 10

Shlyerja e huas së butë

10.1 Pas disbursimit të parë të fondeve në llogarinë e veçantë, Artigiancassa do t'i transmetojë Huamarrësit me letër, grafikun e shlyerjes për shumën e disbursuar, duke treguar datat e pagesave në lidhje me to. Çdo grafik shlyerjeje, i plotësuar në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 10.2, pranohet nga Huamarrësi me shkrim.

10.2 Çdo shumë e kredituar nga Artigiancassa në llogarinë e veçantë do të shlyhet në përputhje me grafikun e shlyerjes në 16 (gjashtëmbëdhjetë) këste të njëpasnjëshme, të shpërndara në mënyrë të barabartë, gjysmëvjeçare (prej këtu e më poshtë të quajtura "këste të principalit"), i pari prej të cilëve është i kërkueshëm 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) muaj nga data e kreditimit të disbursimit të parë. Artigiancassa do t'i dërgojë Huamarrësit grafikun e parashikuar të shlyerjes në përputhje me nenet 7.11, 8.9 dhe 9.7. Për çdo shlyerje, Huamarrësi i bën të ditur Artigiancassa-s numrin e marrëveshjes financiare dhe shumën e përgjithshme të huas së butë dhe do të shpjegojë për çdo datë të kërkueshme shumat e paguara.

10.3 Huamarrësi merr përsipër të bëjë të gjitha pagesat dhe shlyerjet e kërkueshme sipas kësaj marrëveshjeje, si dhe sipas njohjes së borxhit pa vonesë në datën përkatëse të kërkueshme për shumën përkatëse në euro, në favor të Artigiancassa-s ose personit/ave që e kanë këtë të drejtë. Këto shuma do të kreditohen pa zbritje të asnjë tarife bankare apo këmbimi dhe/ose tatimi dhe pa njoftuar për këtë Artigiancassa-n ose personat që e kanë këtë të drejtë.

Neni 11

Dhënia e njohjes së borxhit

11.1 Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike nga data e fundit e skadimit të disbursimit të huas së butë të parashikuar në nenin 6.1, Huamarrësi do t'i paraqesë Artigiancassa-s njohjen e borxhit të nënshkruar rregullisht dhe të sigluar nga Huamarrësi në çdo faqe, në formatin e aneksit B.

11.2 Grafiku i shlyerjes i parashikuar në njohjen e borxhit do të plotësohet duke mbledhur të gjitha këstet e principalit që nuk janë maturuar akoma dhe këstet që janë maturuar, por nuk janë paguar

në datën e paraqitjes së njohjes së borxhit, të parashikuara në grafikun përkatës të shlyerjes për çdo disbursim, në përputhje me dispozitat e nenit 10.2.

11.3 Artigiancassa do të depozitojë njohjen e borxhit për regjistrimin dhe administrimin e saj dhe herë pas here regjistron në njohjen e borxhit çdo pagesë të shumës së principalit dhe, sapo të jenë bërë të gjitha pagesat e parashikuara në njohjen e borxhit, ia kthen atë Huamarrësit të nënshkruar rregullisht për marrje.

Neni 12

Detyrimi i Huamarrësit

Detyrimi i Huamarrësit për të paguar shumat e kërkueshme, sipas kësaj marrëveshjeje dhe njohjes së borxhit në lidhje me të, është i pavarur, absolut, pa kushte dhe i pakthyeshëm.

Neni 13

Pengesat dhe forca madhore

Në rastin e pengesave për zbatimin e programit për shkak të forcave madhore (si: luftës, përmytjes, tajfunit, zjarrit, tërmetit, konflikteve të punës dhe grevave, aktit të çdo qeverie, vështirësive të papritura transporti dhe shkaqeve të tjera) do të zbatohen dispozitat e specifikuar në nenin 15 të PA-së. Artigiancassa ndjek udhëzimet e autoriteteve kompetente italiane në lidhje me aktivitetet e programit.

Neni 14

Pezullimi i disbursimit

14.1 Gjatë periudhës së disbursimit të huas së butë, Artigiancassa rezervon të drejtën të pezullojë çdo kërkesë disbursimi sipas neneve 7, 8 dhe 9 në rastin e një vonese kundrejt Artigiancassa-s sipas kësaj marrëveshjeje apo në rast se ndodh një vonesë ndaj një huaje të butë tjetër të dhënë nga Qeveria e Republikës së Italisë për Qeverinë ose Bankën Qendrore ose për agjencitë shtetërore të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 6 të ligjit nr. 38 të datës 9 shkurt 1979 dhe nenit 6 të ligjit nr. 49 të datës 26 shkurt 1987 të Republikës së Italisë të ndryshuar herë pas here. Artigiancassa do të informojë në kohë Huamarrësin për këtë pezullim.

14.2 Artigiancassa do të ekzekutojë çdo kërkesë për disbursim të parashikuar në nenet 7, 8 dhe 9 në rast se shumat përkatëse bëhen të disponueshme nga autoritetet kompetente italiane. Artigiancassa nuk do të konsiderohet përgjegjëse kundrejt Huamarrësit në rast se shumat që duhet të disbursohen sipas huas së butë nuk ofrohen nga autoritetet kompetente italiane.

Neni 15

Interesi i munguar

15.1 Nëse për një arsye çfarëdo Artigiancassa nuk merr shumat e kërkueshme për principalin brenda datës së kërkueshme, Huamarrësi do të jetë i detyruar të paguajë, për shumat në fjalë, interesin e munguar nga data e kërkueshme deri në datën e kreditimit faktik në favor të Artigiancassa-s ose të personit(ave) që kanë këtë të drejtë.

15.2 Ky interes i munguar do të llogaritet duke zbatuar formulën e thjeshtë të interesit.

Interesi i munguar nuk do të llogaritet për periudhën prej 35 (tridhjetë e pesë) ditësh menjëherë pas datës fillestare të kërkueshme dhe, pas kësaj, me normën 1.75% (një pikë shtatëdhjetë e pesë për qind) deri në datën e kreditimit faktik në favor të Artigiancassa-s. Ky interes i munguar do të llogaritet periodikisht nga autoritetet kompetente italiane.



Neni 16 Taksat

16.1 Çdo taksë e tanishme apo e ardhshme që mund të jetë e kërkueshme në Republikën e Shqipërisë për një arsye çfarëdo në lidhje me këtë marrëveshje dhe njohjen e borxhit, do të mbulohet ekskluzivisht nga Huamarrësi.

16.2 Çdo taksë e kërkueshme në Itali në lidhje me këtë marrëveshje nuk do të mbulohet nga Huamarrësi.

16.3 Artigiancassa deklaron se do të përdorë statusin tatimor të parashikuar në nenin 19 të dekretit të Presidentit të Republikës nr. 601 të datës 29 shtator 1973, të ndryshuar herë pas here.

Neni 17 Ligji rregullues

Kjo marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjin italian.

Neni 18 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

18.1 Palët do të përpiqen të zgjidhin në mënyrë miqësore çdo mosmarrëveshje që rrjedh nga interpretimi dhe/ose ekzekutimi i kësaj marrëveshjeje.

18.2 Nëse këto përpjekje nuk do të çojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve brenda një afati kohe të arsyeshëm, mosmarrëveshja zgjidhet në nivel qeveritar.

18.3 Nëse edhe kjo përpjekje do të dështojë apo (nëse përpjekja bëhet) ajo nuk do të ketë një rezultat të pranueshëm, të gjitha mosmarrëveshjet nga ose në lidhje me këtë marrëveshje do të zgjidhen përfundimisht sipas Rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris, Francë, nga një gjykatë arbitrazhi e përbërë nga tre arbitra:

- një i emëruar nga Huamarrësi;
- një i emëruar nga Artigiancassa;
- arbitri i tretë emërohet nga arbitrat e sipërpërmendur ose në rastin e mosmarrëveshjes mes tyre, nga kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris.

18.4 Nëse Huamarrësi ose Artigiancassa nuk i emërojnë arbitrat e tyre brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga kërkesa e palës tjetër, arbitri emërohet nga kryetari i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Paris.

18.5 Vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit, e cila do të vendosë në përputhje me ligjin e Republikës së Italisë, do të jetë përfundimtar dhe detyrues pa kushte për të dyja palët pa asnjë mundësi ankimi.

18.6 Asnjë mosmarrëveshje apo konflikt që mund të lindë ndërmjet palëve nuk do të pezullojë detyrimin e Huamarrësit për të paguar, në datat e kërkueshme të rëna dakord, të gjitha shumat e kërkueshme sipas kësaj marrëveshjeje dhe veçanërisht të gjitha shumat që rrjedhin nga grafikët e shlyerjes të parashikuar në nenet 7, 8 dhe 9 dhe nga njohja e borxhit në lidhje me to.

Neni 19 Njoftimet

Njoftimet që bëhen në përputhje me këtë marrëveshje do të adresohen si më poshtë:

- Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri

Tel.: +355-4-2228405 - Fax: +355-4-2228494

- Artigiancassa S.p.A. Njësia e Menaxhimit të Fondit Qarkullues - Via Crescenzo Del Monte 25, - 00153 Rome - Italy

Telefoni i zyrës +39-06/5845374/414 Fax +39-06/5845466 fondorotativo@artigiancassa.it

Neni 20

Tekstet origjinale të marrëveshjes financiare

Kjo marrëveshje nënshkruhet në tri kopje origjinale në gjuhën angleze. Artigiancassa mban dy kopje origjinale dhe Huamarrësi një kopje origjinale.

Artigiancassa S.p.A.
Nënshkruar në më

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë
i përfaqësuar nga Ministria e Financave
Nënshkruar në më

(Formulari i kërkesës për disbursim)

Aneksi A

Nga: (Huamarrësi)
Drejtuar: Artigiancassa S.p.A.

Marrëveshja financiare prej eurosh e nënshkruar prej nesh në më dhe nga Artigiancassa S.p.A. në më

Në përputhje me nenin të marrëveshjes financiare të sipërpërmendur, ne kërkojmë që të kreditoni brenda 30 (tridhjetë) ditësh, në llogarinë e veçantë (sipas përcaktimit të atjeshëm) n. IBAN dhe të hapur te Banka, shumën prej euro (.....), me kusht që fondet përkatëse të jenë bërë të disponueshme nga autoritetet kompetente italiane (sipas përcaktimit të atjeshëm).

Fondet e kredituara nga ju në llogarinë e veçantë përdoren për zbatimin e programit “.....”.

Ne këtu marrim përsipër pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme të shlyejmë shumën e sipërpërmendur prej eurosh, të kredituara prej jush në llogarinë e veçantë, sipas termave dhe kushteve të parashikuara në marrëveshjen financiare të sipërpërmendur.

Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga data e skadimit të disbursimit të huas së butë, ne marrim përsipër t’i paraqesim Artigiancassa S.p.A. një njohje të borxhit për të gjitha shumat e disbursuara sipas marrëveshjes financiare të sipërpërmendur.

Kjo njohje e borxhit do të jetë në formatin e aneksit B të marrëveshjes financiare të sipërpërmendur.

Sinqerisht juaji,

Datë ...

(Nënshkrimi i Huamarrësit)

.....

(Formulari i njohjes së borxhit)

Aneksi B

..... (Huamarrësi)

N.

Vendi dhe data e lëshimit:

Në lidhje me marrëveshjen e programit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë të nënshkruar në ... më ... dhe marrëveshjen financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave (prej këtu e më poshtë “Huamarrësi”) dhe Artigiancassa S.p.A. (prej këtu e më poshtë “Artigiancassa”), të nënshkruar në ... më dhe në më, Huamarrësi njeh marrjen e shumave të mëposhtme nga Artigiancassa:

EURO on

EURO on



Kështu, Huamarrësi pa kushte dhe në mënyrë të përvokueshme deklaron se është debitor i Artigiancassa, si administrator, për llogari të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Italisë, të Fondit Qarkullues të Bashkëpunimit për Zhvillimin me seli të regjistruar në Romë (Itali), Via Crescenzo del Monte, 25, për shumën principale prej eurosh (.....), që ndërmerr të shlyejë në ... (...) këste të barabarta [të njëpasnjëshme] gjysmëvjetore, i pari prej të cilëve bëhet i kërkueshëm më dhe i fundit më, sipër grafikut të shlyerjes të parashikuar më poshtë.

Huamarrësi i paguan këstet e principalit (sipas përkufizimit në konventën financare) të parashikuara në këtë njohje borxhi, duke kredituar shumat përkatëse në euro, në datat e rëna dakord, në favor të Artigiancassa, ose të personit/ave me këto të drejta, në llogarinë të Banca Nazionale del Lavoro S.p.A., të lirë nga çdo tarifë bankare dhe/ose konvertimi.

Nëse Artigiancassa, për çdo lloj arsyeje, duke përfshirë shkaqet tej kontrollit të Huamarrësit, nuk merr shumat e kërkueshme për principalin të parashikuara sipas kësaj njohje borxhi, brenda datës së kërkueshme, Huamarrësi do të jetë i detyruar të paguajë për këto shuma në llogarinë të Banca Nazionale del Lavoro S.p.A., interesin e munguar nga data e kërkueshme deri në datën faktike të kreditimit në favor të Artigiancassa-s ose të personit/ave me këto të drejta.

Ky interes i munguar do të llogaritet duke zbatuar formulën e thjeshtë të interesit. Interesi i munguar nuk llogaritet për periudhën prej 35 (tridhjetë ditësh) menjëherë pas datës fillestare të kërkueshme dhe, pas kësaj, do të llogaritet me normën 1.75% (një pikë shtatëdhjetë e pesë për qind) në vit deri në datën e kreditimit faktik në favor të Artigiancassa-s.

.....

(Inicialet e Huamarrësit)
të vazhdohet

Aneksi B ctd.

Artigiancassa do të shënojë herë pas here në këtë njohje borxhi çdo pagesë principali.

Menjëherë sapo të jenë bërë të gjitha pagesat e renditura në grafikun e shlyerjes të parashikuar më poshtë, kjo njohje borxhi do t'i kthehet Huamarrësit, nëpërmjet Artigiancassa-s.

Kjo njohje borxhi lëshohet në përputhje me huan e butë prej 15,000,000.00 eurosh (pesëmbëdhjetë milionë/00) të dhënë në pajtim me nenin 6 të ligjit nr. 49 të datës 26 shkurt 1987 të Republikës së Italisë.

GRAFIKU I SHLYERJES

Data e maturimit	Këstet e principalit	Totali
a)
b)
c)
d)
.....	
1)
2)
3)
4)
5)
6)
7)
8)
9)
10)
.....

(.....)

(Nënshkrimi i Huamarrësit)

LIGJ
Nr. 148/2013

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI PËR MBROJTJEN E
NDËRSJELLË TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 6.5.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8185, datë 21.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
MALIT TË ZI MBI MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INFORMACIONIT
TË KLASIFIKUAR**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Malit të Zi (më poshtë quhen “Palët”):

duke njohur rolin e rëndësishëm të bashkëpunimit të tyre reciprok për stabilizimin e paqes, sigurisë ndërkombëtare dhe besimit reciprok;

duke njohur që bashkëpunimi i mirë kërkon shkëmbimin e informacionit të klasifikuar ndërmjet palëve;

duke njohur nevojën për vendosjen e rregullave për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të shkëmbyer brenda sferës së bashkëpunimit politik, ushtarak, ekonomik, ligjor, shkencor dhe teknologjik apo tjetër, si dhe informacionit të klasifikuar që del në procesin e këtij bashkëpunimi;

me synim sigurimin e mbrojtjes reciproke të të gjithë informacionit të klasifikuar, që është klasifikuar nga një palë dhe transferuar palës tjetër;

me dëshirën për të vendosur rregulla për mbrojtjen reciproke të informacionit të klasifikuar, që do të shtrihet te të gjitha marrëveshjet mbi bashkëpunimin që do të lidhen ndërmjet palëve dhe kontratat që do të jepen ndërmjet organizatave të palëve, që parashikojnë shkëmbimin e informacionit të klasifikuar,

kanë rënë dakord si më poshtë:



Neni 1 Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj marrëveshjeje:

1. “Informacion i klasifikuar” do të thotë:

- Për Republikën e Shqipërisë

“Sekret shtetëror”, sipas ligjit, do të thotë informacioni i klasifikuar, ekspozimi i paautorizuar i të cilit mund të dëmtojë sigurinë kombëtare. Siguri kombëtare do të thotë mbrojtje e pavarësisë, integritetit territorial, rendit kushtetues dhe marrëdhëniet e huaja të Republikës së Shqipërisë.

- Për Malin e Zi:

“Informacion i klasifikuar” është informacioni, zbulimi i të cilit te personat e paautorizuar ka ose mund të ketë pasoja të dëmshme për sigurinë, interesat politike ose ekonomike të Malit të Zi dhe lidhet me mbrojtjen, sigurinë kombëtare, çështjet e jashtme, aktivitetet e shërbimeve të fshehta dhe sigurisë të agjencive të Malit të Zi, kërkimin shkencor, çështjet teknologjike, ekonomike dhe financiare me rëndësi për sigurinë publike, mbrojtjen, çështjet e huaja dhe sigurinë publike, dhe aktivitetet e shërbimeve të fshehta dhe sigurisë të agjencive të Malit të Zi dhe sistemet, instrumentet, projektet dhe planet me rëndësi për mbrojtjen, sigurinë publike, çështjet e huaja dhe aktivitetet e shërbimeve të fshehta dhe sigurisë së agjencive shtetërore të Malit të Zi.

2. “Dokument i klasifikuar” është çdo informacion i regjistruar, pavarësisht nga forma ose karakteristikat fizike, duke përfshirë, pa kufizim, çështjet e shkruara ose të printuara, kartat e përpunimit të të dhënave dhe kasetat, hartat, tabelat, fotografitë, pikturat, vizatimet, gdhendjet, skicat, shënimet dhe letrat e punës, kopjet e karbonit dhe shiritat e bojës, ose riprodhimet me çdo mjet ose proces, dhe regjistrimet e tingujve, zanore, manjetike ose elektronike apo optike ose vizuale në çdo format dhe pajisjet portative të automatizuara të përpunimit të të dhënave me mjete komunikimi stacionare për ruajtje kompjuterike dhe mjete komunikimi portative të ruajtjes kompjuterike.

3. “Material i klasifikuar” është ndonjë pjesë makinerie, ose armë apo pajisje, ose mjete, të prodhuar ose në proces prodhimi, që ruan, përpunon ose transmeton informacion të klasifikuar.

4. “Palë pritëse” është pala së cilës i transmetohet informacioni ose materiali i klasifikuar.

5. “Pala e origjinës” është pala që nis informacionin ose materialin e klasifikuar.

6. “Pala e tretë” është një organizatë ndërkombëtare ose një shtet i tretë që nuk është palë në këtë marrëveshje.

7. “Autoriteti kompetent i sigurisë” është autoriteti, i cili në pajtim me legjislacionin e brendshëm të palës përkatëse, përmbush politikën kombëtare për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, ushtron kontroll të përgjithshëm në këtë sferë, si dhe kryen zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Këto autoritete janë renditur në nenin 4 të kësaj marrëveshjeje.

8. “Parimi “nevojë për njohje”” është domosdoshmëria për të pasur akses në informacionin e klasifikuar në lidhje me detyrat zyrtare dhe/ose përmbushjen e një detyre zyrtare konkrete.

9. “Kontraktor” është një subjekt fizik ose juridik që ka cilësinë juridike për të lidhur kontrata të klasifikuara.

10. “Kontratë e klasifikuar” është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë autoriteteve shtetërore ose subjekteve juridike, që krijojnë ose përcaktojnë të drejta dhe detyrime të ekzekutueshme ndërmjet tyre. Që përmbajnë ose përfshijnë informacion të klasifikuar.

11. “Vizitorë” janë përfaqësues zyrtarë të një pale që kërkojnë të vizitojnë objektet dhe mjediset e palës tjetër, të përfshirë aktivitetet që kanë të bëjnë me informacionin ose materialin e klasifikuar.

12. “Certifikatë sigurie personeli” është dokumenti i dhënë nga autoriteti komponent i sigurisë, për një shtetas të një pale për akses tek informacioni ose materiali i klasifikuar, në pajtim me legjislacionin përkatës të brendshëm.

13. “Certifikatë sigurie industriale” është dokumenti i dhënë nga autoriteti komponent i sigurisë që provon se një shoqëri/strukturë ka mundësinë fizike dhe organizative të përdorë dhe të depozitojë informacionin ose materialin e klasifikuar, në pajtim me legjislacionin përkatës të brendshëm.

14. “Shkelje e sigurisë” është një veprim ose mosveprim në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm, që rezulton ose mund të rezultojë në akses të paautorizuar në informacionin e klasifikuar.

Neni 2 **Zbatueshmëria**

Kjo marrëveshje përfshin të gjitha aktivitetet, në kuadrin e të cilëve gjenerohet ose shkëmbehet informacion i klasifikuar ndërmjet palëve ose një individi apo një subjekti juridik nën juridiksionin e shteteve të tyre, me qëllim që të përmbushin detyrat e tyre publike.

Neni 3 **Nivelet e klasifikimit të sigurisë**

Palët bien dakord që nivelet e mëposhtme të sigurisë janë të barasvlershme dhe përputhen me nivelet e klasifikimit të sigurisë të specifikuar në legjislacionin e brendshëm të palës përkatëse.

Për Republikën e Shqipërisë	Ekivalenti në anglisht	Për Malin e Zi
Tepër sekret	Top Sekret	Strogo Tajno
Sekret	Secret	Tajno
Konfidencial	Confidential	Povjerljivo
I kufizuar	Restricted	Interno

Neni 4 **Autoritetet kompetente të sigurisë**

1. Autoritetet kompetente të sigurisë së palëve janë si më poshtë:
 - Për Republikën e Shqipërisë
Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (Autoriteti i Sigurisë Kombëtare)
 - Për Malin e Zi
Drejtoria për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar (Autoriteti i Sigurisë Kombëtare).
2. Autoritetet kompetente të sigurisë njoftojnë njëra-tjetrën për legjislacionin e brendshëm në fuqi që rregullon mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.
3. Me qëllim që të sigurohet bashkëpunim i ngushtë në zbatimin e kësaj marrëveshjeje, autoritetet kompetente të sigurisë mund të zhvillojnë konsultime me kërkesën e bërë nga njëra prej tyre.
4. Me qëllim që të arrijnë dhe të ruajnë standarde të krahasueshme sigurie, autoritetet kompetente të sigurisë, me kërkesë, i japin njëra-tjetrës informacion në lidhje me standardet, procedurat dhe praktikën e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

Neni 5 **Parimet e sigurisë**

1. Në pajtim me legjislacionin e tyre të brendshëm, palët zbatojnë të gjitha masat e përshtatshme për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, që gjenerohet ose shkëmbehet përgjithësisht sipas kësaj marrëveshjeje. I njëjti nivel mbrojtjeje do të sigurohet për këtë informacion të klasifikuar, siç parashikohet dhe për informacionin e klasifikuar të brendshëm, me nivelin përkatës të klasifikimit të sigurisë.
2. Palët njoftojnë njëra-tjetrën në kohën e duhur në lidhje me ndryshimet në legjislacionin që ndikon në mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Në këto raste, palët njoftojnë njëra-tjetrën në pajtim me nenin 4, paragrafët 3 dhe 4, të kësaj marrëveshjeje me qëllim që të diskutojnë ndryshimet e mundshme të kësaj marrëveshjeje. Ndërkohë, informacioni i klasifikuar mbrohet në pajtim me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, përveç kur bihet dakord ndryshe me shkrim.



3. Aksesit në informacionin e klasifikuar kufizohet tek ata persona që kanë nevojë për njohje, dhe janë certifikuar nga autoriteti kompetent i sigurisë, në pajtim me legjislacionin e brendshëm, në përputhje me nivelin e kërkuar të klasifikimit të sigurisë të informacionit, i cili aksesohet.

4. Pala pritëse është e detyruar:

a) të mos i japë informacion të klasifikuar një pale të tretë pa aprovimin e mëparshëm me shkrim të palës së origjinës;

b) t'i vendosë informacionit të klasifikuar nivelin e klasifikimit të sigurisë të barasvlershëm me atë të parashikuar në nenin 3 të kësaj marrëveshjeje dhe në vazhdimësi të sigurojë mbrojtje;

c) të mos e përdorë informacionin e klasifikuar për qëllime të ndryshme nga ato për të cilat është dhënë;

d) të respektojë të drejtat e pronësisë intelektuale dhe sekretet tregtare që janë përfshirë në informacionin e klasifikuar.

Neni 6

Transmetimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar transmetohet nëpërmjet shërbimeve diplomatike ushtarake dhe shërbimeve të tjera postare të aprovuara nga autoritetet kompetente të sigurisë. Pala pritëse konfirmon me shkrim marrjen e informacionit të klasifikuar.

2. Nëse duhet të transmetohet një dërgesë e madhe që përmban informacion të klasifikuar, autoritetet kompetente të sigurisë bien bashkërisht dakord dhe aprovojnë mjetet e transportit, itinerarin dhe masat e sigurisë për secilin rast.

3. Mjetet e tjera të aprovuara të transmetimit ose shkëmbimit të informacionit të klasifikuar, duke përfshirë mjetet elektro-manjetike, mund të përdoren nëse bihet dakord nga autoritetet kompetente të sigurisë.

Neni 7

Shenjzimi i informacionit të klasifikuar

1. Pala pritëse shenjzëson informacionin e klasifikuar me shenjzimin përkatës të klasifikimit në pajtim me nenin 3.

2. Kopjet, riprodhimet dhe përkthimet e informacionit të klasifikuar të marrë, shenjzohen dhe trajtohen në të njëjtën mënyrë, si dhe origjinalet.

3. Kërkesat për shenjzim zbatohen, gjithashtu, edhe për informacionin e klasifikuar të gjeneruar në lidhje me një kontratë të klasifikuar.

Neni 8

Riprodhimi dhe përkthimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar i shenjzuar me një nivel të klasifikimit të sigurisë TEPËR SEKRET/TOP SECRET/STROGO TAJNO lejohet për përkthimi dhe kopjim vetëm me lejen me shkrim të autoritetit kompetent të sigurisë së palës së origjinës.

2. Të gjitha kopjet e riprodhuara të informacionit të klasifikuar shenjzohen me shenjzimin e klasifikimit origjinal. Ky informacion i riprodhuar vendoset në të njëjtin kontroll, si dhe informacioni origjinal. Numri i kopjeve kufizohet në atë që kërkohet për qëllime zyrtare.

3. Të gjitha përkthimet e informacionit të klasifikuar bëhen nga individë të certifikuar. Përkthimi shenjzohet me shenjën e klasifikimit origjinal dhe mban një shënim të përshtatshëm në gjuhën në të cilën është përkthyer, që përkthimi përmban informacion të klasifikuar të palës së origjinës.

Neni 9

Asgjësimi i informacionit të klasifikuar

1. Informacioni i klasifikuar asgjësohet deri në atë masë sa të pengohet rindërtimi i plotë ose i pjesshëm i tij.

2. Informacioni i klasifikuar me nivel klasifikimi sigurie si TEPËR SEKRET/TOP SECRET/STROGO TAJNO nuk asgjësohet. Ai i kthehet autoritetit kompetent të sigurisë të palës së origjinës.

3. Pala e origjinës, me anë të shenjëzimeve shtesë ose dërgimit të njoftimit pasues me shkrim, mund të ndalojë shprehimisht kopjet, riprodhimin, ndryshimin ose asgjësimin e informacionit të klasifikuar. Nëse ndalohet asgjësimi i informacionit të klasifikuar, ai i kthehet palës së origjinës.

4. Në rastin e një situatë krize, informacioni i klasifikuar, i cili është i pamundur për t'u mbrojtur ose kthyer palës së origjinës, asgjësohet menjëherë. Pala pritëse njofton palën e origjinës në lidhje me asgjësimin e informacionit të klasifikuar.

Neni 10

Kontratat e klasifikuara

1. Kontratat e klasifikuara lidhen dhe zbatohen në pajtim me legjislacionin e brendshëm të secilës palë. Me kërkesë Autoriteti kompetent i sigurisë i secilës palë jep konfirmimin, që një kontraktues i propozuar është pajisur me një certifikatë të përshtatshme kombëtare sigurie industriale, sipas nivelit të kërkuar për klasifikimin e sigurisë. Nëse kontraktori i propozuar nuk ka certifikatën e përshtatshme të sigurisë industriale, autoriteti kompetent i sigurisë i secilës palë mund të kërkojë që ai kontraktor të certifikohet.

2. Një klauzolë sigurie do të jetë pjesë integrale e çdo kontrate të klasifikuar ose nënkontrate, nëpërmjet së cilës kontraktori i palës së origjinës specifikon se cili informacion i klasifikuar do t'i jepet ose gjenerohet nga pala pritëse dhe nivelin përkatës të klasifikimit të sigurisë, i cili është caktuar këtij informacioni.

3. Detyrimet e kontraktorit për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar sipas një kontrate të klasifikuar u referohen, të paktën, sa më poshtë:

a) zbulimi i informacionit të klasifikuar ekskluzivisht personave që janë pajisur paraprakisht me certifikatën e përshtatshme të sigurisë së personelit, të cilët kanë nevojë për njohje dhe që janë punësuar ose përfshirë në përmbushjen e kontratës;

b) transferimi i informacionit të klasifikuar me mjete sipas dispozitave të kësaj marrëveshjeje;

c) procedurat dhe mekanizmat e komunikimit të ndryshimeve që mund të lindin në lidhje me informacionin e klasifikuar për shkak të ndryshimeve në nivelin e klasifikimit të sigurisë ose në rastin e deklasifikimit;

d) detyrimin për të njoftuar në kohën e duhur autoritetin kompetent të sigurisë së kontraktorit, për çdo akses faktik, në tentativë ose të dyshuar, të paautorizuar në informacionin e klasifikuar të kontratës;

e) përdorimi i informacionit të klasifikuar sipas kontratës vetëm për qëllimet në lidhje me objektin e kontratës;

f) respektimi rigoroz i dispozitave të kësaj marrëveshjeje në lidhje me procedurat për asgjësimin e informacionit të klasifikuar;

g) dhënien e informacionit të klasifikuar sipas një kontrate të klasifikuar një pale të tretë vetëm me pëlqimin paraprak me shkrim të palës së origjinës.

4. Masat e kërkuara për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, si dhe procedura për vlerësimin dhe zhdëmtimin për humbje të mundshme të shkaktuara kontraktorëve nga aksesit i paautorizuar në informacionin e klasifikuar duhet të specifikohet me më shumë hollësi në kontratën e klasifikuar përkatëse.



5. Kontrata e klasifikuar me nivel klasifikimi sigurie i “kufizuar/restricted/interno” përmban një klauzolë të përshtatshme të sigurisë që identifikon masat minimale për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Për këto kontrata nuk kërkohet certifikatë sigurie industriale.

Neni 11

Vizitat

1. Autoriteti kompetent i sigurisë i palës pritëse lëshon autorizim paraprak për vizitë për të gjithë vizitorët e palës tjetër, të cilët kanë certifikatë sigurie personeli të përshtatshme, në rast se atyre u nevojitet të kenë akses në informacionin e klasifikuar ose në mjedise ku ka origjinën, trajtohet ose ruhet informacioni i klasifikuar.

2. Për procedurat e vizitave bihet dakord nëpërmjet autoriteteve kompetente të sigurisë së palëve.

3. Kërkesa për vizitë përmban, të paktën, informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin dhe mbiemrin e vizitorit, datën dhe vendin e lindjes, numrin e pasaportës;
- b) kombësinë/shtetësinë e vizitorit;
- c) emërtesën e pozicionit të vizitorit dhe emrin e organizatës që përfaqëson;
- d) Certifikatën e Sigurisë së Personelit të vizitorit me nivelin e përshtatshëm të klasifikimit;
- e) qëllimin, programin e propozuar të punës dhe datën e planifikuar të vizitës;
- f) emrin e organizatave dhe strukturave që kërkohen të vizitohen.

4. Autoritetet kompetente të sigurisë së palëve aprovojnë listën e vizitorëve që mund të përsërisin vizitat brenda dymbëdhjetë muajve për qëllimin e përbushjes së një kontrate të klasifikuar. Kushtet e vizitave specifike përcaktohen drejtpërdrejt me autoritetet përkatëse të kontraktorëve.

5. Secila palë garanton mbrojtjen e të dhënave personale të vizitorëve, sipas legjislacionit përkatës të brendshëm.

Neni 12

Shkelja e sigurisë

1. Në rastin e shkeljes së sigurisë, autoriteti kompetent i sigurisë në shtetin e të cilit ka ndodhur shkelja e sigurisë njofton autoritetin kompetent të sigurisë të palës tjetër në kohën e duhur dhe siguron hetim të përshtatshëm. Nëse kërkohet, pala tjetër bashkëpunon në hetim.

2. Në rast se shkelja e sigurisë ndodh në një palë të tretë, autoriteti kompetent i sigurisë i palës pritëse ndërmerr të gjitha veprimet sipas paragrafit 1 të këtij neni, sipas rastit.

3. Pala tjetër njoftohet për rezultatet e hetimit dhe merr një deklaratë përfundimtare në lidhje me shkaqet e ngjarjes dhe masën e dëmit.

Neni 13

Shpenzimet

Secila palë mbulon shpenzimet e veta të bëra gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Neni 14

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje zgjidhet me konsultime dhe bisedime ndërmjet Palëve dhe nuk i paraqitet asnjë gjykatë ndërkombëtare apo një Pale të tretë.

Neni 15
Dispozita të fundit

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet të cilit Palët kanë njoftuar njëra-tjetrën, nëpërmjet kanaleve diplomatike që kërkesat e tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi janë përmbushur.

2. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e përbashkët me shkrim të palëve. Ndryshimet hyjnë në fuqi në pajtim me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

3. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar kohe. Secila palë mund të denoncojë këtë marrëveshje duke i bërë palës tjetër njoftim me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike. Në këtë rast, kjo marrëveshje përfundon gjashtë (6) muaj nga data në të cilën pala tjetër ka marrë njoftimin e denoncimit.

4. Në rastin e përfundimit të kësaj marrëveshjeje, i gjithë informacioni i klasifikuar i transferuar ndërmjet palëve vazhdon të mbrohet në pajtim me dispozitat e parashikuara në të.

Bërë në Tiranë, më 11 mars 2013 në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, malazeze dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj të barasvlershme. Në rastin e mospërputhjes në interpretim, mbizotëron teksti në anglisht.

LIGJ
Nr. 149/2013

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 2, DATË 2.5.2013, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË
SË PALUAJTSHME”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 2.5.2013, i Këshillit të Ministrave “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”.

Miratuar në datën 6.5.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8186, datë 21.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**



LIGJ
Nr. 150/2013

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 3, DATË 3.5.2013, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT
PËR ZHVILLIM ABU DHABI PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË BULEVARDIT VERIOR
DHE TË REHABILITIMIT TË LUMIT TË TIRANËS”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 3.5.2013, i Këshillit të Ministrave “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit për Zhvillim Abu Dhabi për financimin e projektit të bulevardit verior dhe të rehabilitimit të Lumit të Tiranës”.

Miratuar në datën 6.5.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8187, datë 21.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 27.5.2013
Doli nga shtypi më 27.5.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 40 lekë